

HEJZA

Xhevdet BAJRAJ

Ia vlen t'i kushtohet jeta shkrimit. Se librat edhe pas ikjes sonë nga kjo botë mbeten gjallë, përveç atyre që kanë lindur të vdekur dhe lëvizin poshtë e lart, të tjerët e kanë jetën e tyre

SHTETI DHE IDENTITETI KULTUROR

Kultura nuk guxon të trajtohet si mundësi përfitimi, si obligim apo si një privilegj vetëm i një personi, vetëm i një institucioni apo vetëm i një segmenti kohor. Kultura është shtylla vertebrale e kombit. Për të qenë i lëvizshëm kombi duhet që t'i funksionojnë dhe t'i ketë të shëndosha të gjitha vertebrat e shtyllës së vet

Avni HALIMI

Për nga kuptimi politik, shteti është një organizatë e gjithanshme e cila disponon kapacitete dhe mekanizma të domosdoshëm për ta shtrirë sundimin politik mbi tërë shoqërinë. Për nga kuptimi gjeo-politik shteti është një territor me kufij të caktuar, i populluar nga popuj të caktuar që udhëhiqen nga një pushtet publik. Popullsia dhe territori janë dy elementet kyçe që e përbëjnë një shtet, sepse pa popullsi dhe pa territor nuk ka shtet. Ndërkaq pushteti është mjet për ta vënë në zbatim një politikë, një program qeveritar të caktuar mbi tërë shoqërinë e shtetit.

Në shtetet demokratike, në shtetet shumëpartiake, pushteti ushtrohet përmes institucioneve juridikisht të ngritura me vullnetin e gjithë shtetasve të cilët aderojnë nëpër parti të ndryshme. Partitë përfaqësojnë grupe përkatëse shoqërore ndërsa shteti përfaqëson zyrtarisht të gjithë qytetarët e vet.

Po në ç'masë dhe në ç'mënyrë i përfaqëson qytetarët shqiptarë Shteti i Maqedonisë së Veriut? Ose, cili është vullneti i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut që të përfaqësohen nga ky shtet?

Këto janë dy çështje kryesore të cilat, po qe se do të analizoheshin objektivisht, jo vetëm që do të na sillnin te konstatimi i pamohueshëm se, ky shtet akoma është me një pushtet etnocentrik dhe antishqiptar por dhe, nga ana tjetër, do t'i demisionojë edhe partitë prej të cilave përfaqësohen shqiptarët. Maqedonia e Veriut akoma nuk ka vullnet të shëndoshtë për t'i përfaqësuar shqiptarët brenda, ndërsa jashtë shtetit, përfaqëson fund e krye vetëm popullin maqedonas. Kultura shqiptare e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut nuk mund të prezantohet përmes këtij shteti. Në këtë aspekt Maqedonia është shtet që përjashton shqiptarët, ndërsa partitë e tyre vetëpërfshihen nga ky mision. Nuk përjashtohen si numër, por si kulturë!

Mentaliteti popullor dhe kultura

Në shoqëritë post-industriale dhe post-moderniste të disa shteteve perëndimore (Italia, Franca, Gjermania, Spanja, Polonia e disa të tjera, madje edhe Turqia) kishte vite që ishte kryer një studim i detajuar mbi nevojën për konsumim kulturor, mbi shijen kulturore, mbi stilet dhe, përgjithësisht mbi trendet e reja kulturore, sepse institucionet përkatëse të këtyre shteteve gjithnjë e më shumë po bindeshin se teknologjia si dhe kahet e reja shoqërore po impononin politika të reja kulturore. Këtyri procesi studimor iu nënshtroa edhe Serbia dhe Maqedonia e Veriut, si dy nga shtetet më traumatike të dala nga dekomponimet e fundit të ish-federatës jugosllave. Studimi me titull "Nevojat kulturore, shprehjet dhe shija e qytetarëve të Serbisë dhe të Maqedonisë" do të realizohet përmes një mega-ankete e cila do të kryhet gjatë muajve tetor-dhjetor të vitit 2005 (ndërsa fill pas një viti, më 2006-n, do të hidhen hapat e para në projektimin e identitetit të ri kulturor maqedonas si dhe në eksperimentimin e ngjizjes së një identiteti të ri kombëtar në armëz e antikitetit). Projekti në fjalë u financua nga European Cultural Foundation ndërsa u realizua nga Këshilli për iniciativë qytetare nga Nishi, Qendra e artit bashkëkohor nga Shkupi si dhe Qendra për bashkëpunim ballkanik "Loja" nga Tetova. Qëllimi i këtij studimi ishte që t'u dilet në ndihmë të gjithë atyre që merren me krijimin e politikave kulturore



si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë rajonal apo edhe të qyteteve. Gjithashtu, studimi i dedikohet edhe atyre që i formojnë politikat zhvillimore dhe artistike nëpër institucionet kulturore. Dhe, e zezë në të bardhë thuhet: "ky studim i dedikohet në veçanti avancimit të bashkëpunimit të gjithanshëm të Serbisë dhe Maqedonisë".

Nga kjo anketë gjithëpërfshirëse, të kryer në çdo cep të Serbisë e të Maqedonisë, dolën një mori të dhënash shumë të vlefshme për sa i përket asaj se çka dëshirojnë më tepër nga lëmi i kulturës qytetarë e Serbisë dhe të Maqedonisë së Veriut, çka punojnë në këtë drejtim, çka dinë nga lëmi i kulturës, sa shpenzojnë qoftë kohë qoftë nga buxheti familjar për kulturë, dhe çfarë mjeti apo prodhimi kulturor posedojnë. Të dhëna tepër inkurajuese ishin sidomos ato që flisnin për perceptimin kulturor të qytetarëve serbë e maqedonas (mbi leximin e librave, dëgjimin e muzikës, vizitë koncerteve, kinemave, galerive, muzeumeve etj.) si dhe të dhënat që flisnin për produksionin kulturor (sa merren me art qoftë në mënyrë amatore apo profesionale, me cilin lloj të artit merren dhe cili është hobi i tyre). Këto të dhëna mundësoan piketimin dhe diferencimin e katër grupeve (publik pasiv, aktiv, i detyrueshëm dhe jo-publik) nga publiku i teatrit, nga ai i koncerteve, i artit pamor, nga kino-publiku si dhe nga publiku letrar. Veç kësaj u bë edhe identifikimi i grupit kreativ dhe ai jokreativ në fushën e produksionit kulturor. Dhe fare në fund, nga këto të dhëna diferencuese dhe identifikuese u arrit edhe tipologjizimi i shijeve kulturore: shija folklorike, urbane, konvencionale dhe shija elitiste. Por sa kishin bërë këta dy shtete për ta mprehur sidomos shijen e fundit - për të krijuar apo për të ruajtur ndonjë bërthamë të elitës kulturore?

Identiteti i fiksuar

Në korpusin e teorive mbi kulturën, mjaft interesante është edhe ajo teori që mbështetet në "shtetin e mirëqenies". Të dhënat e këtij studimi flasin se aplikimi i kësaj teorie, ndonëse në mënyrë tinzare, mjaft qartë haset në Maqedoninë e Veriut. Si duket ky "shtet i mirëqenies" dhe çka ju ofron qytetarëve të vet? Veprimet e mekanizmave të shtetit të mirëqenies bëhen kryekëput në funksion të përforsimit të lidhjes në mes të konsumimit kulturor dhe përkatësisë etnike-shoqërore,

ndërkohë që, nevoja për nivelizimin e konsumimit material-kulturor i detyron përkatësit e grupeve të tjera etnike të gjejnë dhe të ndajnë burime financiare për aktivitetet e veta kulturore. Kështu përforsohet teza se shteti i mirëqenies dhe mekanizmat e tij mundësojnë më tepër liri individuale ndaj dhe "i motivon" të gjithë shqiptarët që të merren me kulturë por ama paraprakisht të gjejnë dhe të sigurojnë burime financiare. Sot, në kuadër të Ministrisë maqedonase për kulturë "funksionon" edhe e ashtuquajtura Drejtori për zhvillim dhe avancim të kulturave të bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në Maqedoni. Kjo drejtori është absolutisht pa kurrfarë kompetencash dhe, rrjedhimisht, pa kurrfarë buxheti. Përfaqësuesit e grupeve etnike në kuadër të kësaj Drejtorie obligohen që të gjejnë financa nëse dëshirojnë që të zhvillojnë aktivitete kulturore.

Maqedonia aplikon politikën kulturore që del nga kjo teori pikërisht për faktin se "shteti i mirëqenies" konceptohet si promotor i barazisë dhe si dekomponues i ndasive klasore, etnike-shoqërore. Por, duke i pasur parasysh proceset historike, ngjarjet shoqërore dhe ndodhitë politike, a mund të flitet për një funksionim të vërtetë të shtetit të mirëqenies në Serbi dhe në Maqedoninë e Veriut? Absolutisht që jo, sepse ky lloj shteti është karakteristikë e shteteve dhe shoqërive post-industriale e post-moderne. Fatkeqësisht, të dy shtetet skajshmërisht të traumatizuara nga shpartallimi i ish-Jugosllavisë, u kthyen në kohën para-industriale, me shikim drejt mesjetës në vend se të përpiqen guximshëm të ngjiten në Olimpion e modernes. Dhe, në vend se t'i humanizojnë shoqëritë e veta këta dy shtete, i zhytën në përforsimin e identitetit të tyre kolektiv tradicionalisht të fiksuar: serbët si popull bibliq, maqedonasit si popull antik.

Kultura shtyllë vertebrale e kombit

Shoqëritë e shëndosha fuqinë e vet dhe potencialin kombëtar nuk e mbështesin vetëm në llojet e kapitaleve të cilat i definojnë shkenca e ekonomisë por, mbi të gjitha, në kapitalin kulturor. Një shoqëri pa kapital kulturor gjason në një klan mafioz me kapital të fuqishëm material e financiar të cilën e siguron nga nëntoka dhe nga ekonomia e zezë. Kapitali kulturor është gjymtyrët dhe fuqia e identitetit kulturor. Ky kapital përfshinë objektet kulturore, të

mirat kulturore: librat, pikturat, instrumentet...) si dhe institucionet që bartin kualifikime akademike. Por kur ky kapital ekziston dhe nuk shfrytëzohet, nuk konsumohet, nuk vizitohet, nuk mbikëqyret, atëherë shoqëria është në përballje e sipër me disa probleme mjaft brengosëse: nuk funksionon si duhet aparati shtetëror, identiteti kombëtar është në udhëkryq, identiteti kulturor është në dilema të mëdha e historike.

Rezultatet përfundimtare të këtij studimi sollën deri te një konstatim tepër shokues për një shoqëri që mëton të krahasohet me shoqëritë post-moderne. Mbi 75% nga të anketuarit për aktivitetet kulturore konsiderojnë dëgjimin e muzikës folklorike ndërsa po kjo përqindje si vlerë kulturore kombëtare e koncepton turbo-folkun. Rreth 7% prej tyre kanë blerë një libër në vit, 4% prej tyre frekuentojnë teatrot dhe një përqindje shpërfillëse vizitojnë galeritë. Mbi 75% e të anketuarve maqedonas kanë deklaruar se nuk kanë lexuar asnjë libër brenda një viti.

Për t'i zbutur këto probleme, pushteti i krijuar disa muaj pas përfundimit të këtij studimi, politikave e veta kulturore i orientoi pikërisht në drejtim të zbutjes dhe të tejkalimit të këtyre problemeve. Përmes turbo-gjurmimeve arkeologjike u lëshua në ngritje të një identiteti të ri kombëtar, përmes kant-autorëve dhe këngëtarëve zbavitës nisi t'i animojë të rinjtë me shpresë se do të largohen nga turbo-folklori, nisi të derdhë miliona euro në drejtim të botimeve, të aktiviteteve muziko-skenike. Skajshmërisht e instrumentalizuan vdekjen e një këngëtarit argëtues (Toshe Proevski) dhe duke e shtrembëruar profilin e tij profesional, e ngritën në një "shenjtor" të kulturës maqedonase vetëm e vetëm t'ju krijojnë një "idhull" të rinjve maqedonas, të cilët, duke iu kthyer muzikës maqedonase do të hiqnin dorë nga konsumimi i turbo-folkut serbo-maqedonas.

Leximi është bazë e krijimit të shprehive të gjëra kulturore. Shprehja e leximit krijohet që në ciklet e ulta shkollore. Për ta përmirësuar imazhin e popullit lexues, përdoren një nga vlerat më të mëdha kombëtare të kohës së sotme, kardiokirurgun me famë botërore, doktor Zhan Mitrevin. Doktor i fjalë shkroi një libër për fëmijë me titullin Rrëfimet popullore maqedonase mbi Aleksandrin e Madh. Botimi i këtij libri me një tirazh marramendës për kushtet e sotshme u financua nga Ministria e Kulturës, siç u financua edhe përkthimi dhe botimi i tij në gjuhën angleze dhe ruse. Këtë libër do të mund ta përplinte çdo shkronjë mesatar por, politikave kulturore maqedonase e zgjodhën pikërisht këtë "brend kombëtar" pasi që është i dashur dhe i respektuar prej të gjitha shtresave shoqërore maqedonase, thjesht, është krenaria kombëtare maqedonase, ndaj dhe ndikimi tek të rinjtë për lexim do të ishte më i madh. Fatkeqësisht, situata aktuale e librit dhe e konsumimit të tij flet se, përpjekjet e këtyra qeveritare jo vetëm që janë të kota porse edhe shumë naive. Sepse, shprehjet nuk krijohen vetëm nga një faktor dhe aty për aty. Shprehjet kulturore janë rezultat i një procesi të gjerë, gjithëpërfshirës, profesional dhe që sajojnë pikat kyç të programit afatgjatë kombëtar. Kultura nuk guxon të trajtohet si shteg përfitimi, si obligim apo si një privilegj vetëm i një personi, vetëm i një institucioni apo vetëm i një segmenti kohor. Kultura është shtylla vertebrale e kombit. Për të qenë i lëvizshëm kombi duhet që t'i funksionojnë dhe t'i ketë të shëndosha të gjitha vertebrat e shtyllës së vet.

POEZIA BASHKËKOHORE VAZHDON TË PROMOVOHET ME PIKATORE!

A thua se ora e letrave tona poetike të ketë ngecur në vend dhe ne paskemi udhëtuar gjithë këtë kohë në shkretëtirë?

Agim BAJRAMI

Me ka rastisur disa herë të jem i ftuar nëpër aktivitete të ndryshme letrare, organizuar në kuadrin e muajit të letërsisë dhe arteve apo evente të tjerë festive nëpër shkolla të ndryshme publike dhe private, dhe ajo që më ka bërë përshtypje është se repertori i interpretimit nga nxënësit e këtyre shkollave, ka qenë pothuajse i njëjtë me atë që mbajmë në unë nga vitet e mia të fëmijërisë dhe rinisë, me një përjashtim fare të vogël. Kanë hequr "Nëna Shqipëri" dhe "Shqiponjat fluturojnë lart" dhe i kanë zëvendësuar me "Bagëti e bujqësi" e Naim Frashërit, "Poema e mjerimit" e Migjenit, "Kur ti të jesh mërziur shumë" e Agollit, shumë shumë dhe me ndonjë fragment nga "Lahuta e malcisë" e Fishtës. Mund të kem harruar edhe ndonjë fragment nga "Hakërrimë" e Ali Asllanit dhe Pashko Vasos, por megjithatë nuk besoj të kem gabuar shumë në këtë drejtim. Duke i kundruar gjërat nga pozita e një krijuesi dhe dashamirësi të fjalës së bukur, më lind e drejta t'i bëj pyetje atyre që merren me hartimin e programeve të letërsisë në vite dhe vetë organizatorëve përgjegjës. Vetëm kaq pak autorë me emër ka nxjerrë poezia shqipe, që ju ulni e ngrini në çdo aktivitet po ata. A thua se ora e letrave tona poetike të ketë ngecur në vend dhe ne paskemi udhëtuar gjithë këtë kohë në shkretëtirë? A ka pasur vazhdimësi rrjedha poetike tek ne apo ...

Për një njohës të mirë të këtij zhanri, pyetje të tilla tingëllojnë absurde dhe natyrisht që nuk do të jetë dakord, por faktet e konstatuara në terren flasin me gjuhën e të parit. Nga shumica e nxënësve, pak ose aspak, njihen poetët e vërtetë bashkëkohore Fryma e nënçmimit ndaj krijimeve me tendencë soc -realiste, që u ngrit menjëherë mbas viteve 90 -të, vijon të jetë prezente akoma. Jam dakord se nuk është mirë të vazhdojmë t'iu injektojmë brezave ende krijime të infektuara nga kjo rrymë, por ky boshllëk mund të mbushet me krijime me vlerë nga poetë të mrekullueshëm dhe antikonformiste, si Genc Leka, Vilson Blloshmi, Vehbi Skënderi etj, që e kanë kundërshtuar dhe paguar me burg dhe jetë metodën zyrtare të realizmit socialist, në emër të lirisë e tyre së mendimit dhe krijimit. Nëse për opinionet e disave ata nuk ia vlejné, përse ngurrohet ende për t'i njohur nxënësit me brez in e poetëve të spikatur të pas viteve 90, si Frederik Reshpja, Ndoc Gjetja, Visar Zhiti, Ali Podrimja, Agim Gjakova, Mirko Gashi, Skender Buçpapaj, Ilirian Zhupa,

Petrit Ruka, Skënder Rusi, Luljeta Lleshanaku etj., krijimtaria e të cilëve është botuar dhe përkthyer në shumë antologji poetike të Evropës dhe botës, duke u nderuar edhe me çmime të rëndësishme. Poetë të tillë jo vetëm që janë një vazhdimësi e bukur e traditës sonë më të mirë, por edhe e kanë ngritur atë në stadi më të larta artistike. Në këtë rast, nuk do të bëja me faj vetëm hartuesit e programeve mësimore, por edhe drejtoritë arsimore dhe iniciativat e pakta të mësuesve përkatës, të cilët ende nuk e kanë kuptuar rolin e tyre si misionarë të përhapjes të së resë. Duhet të jenë ata që me përzgjedhjet e tyre profesionale të bëhen përçues të arritjeve tona tradicionale dhe bashkëkohore. Është e qartë se shumica e tyre nuk kanë as informacionin më të vogël të gjendjes në të cilën ndodhet poezia jonë me emrat e saj më përfaqësues. Kam qenë dhe do të jem gjithmonë kundër tendencave mohuese të dikujt, që në emër të modernes bën thirrje për mohimin e vlerave të letërsisë së shkuar, ashtu siç nuk do të isha dakord kurrsesi me një pjesë tjetër që me mënyra dhe forma të ndryshme bëjnë gjithçka për të penguar promovimet e krijuesve të bashkëkohësive, stilet, prirjet dhe shkollat e reja poetike, që e kanë bërë poezinë tonë të qëndrojnë në të njëjtin nivel me letërsinë e vendeve të zhvilluara. Elementët e rinj artistikë dhe profilet interesantë, që kanë krijuar ata në vite, nuk mund të fshihen me një të rënë të lapsit vetëm për shkak të shijeve të mangëta ose të kulturës së mangët të dikujt, që e ka në dorë këtë punë. Letërsia tradicionale dhe ajo bashkëkohore janë pjesë e së njëjtës familje dhe si të tilla ato plotësojnë më së miri njëra tjetrën. Një tendencë e tillë vend-numëro, jo vetëm krijon boshllëqe në kulturën letrare të nxënësve, por dhe një realitet të gënjeshtërt të gjendjes së saj faktike. Njëkohësisht, i demotivon dhe i fyen rëndë krijuesit e sotshëm të poezisë sonë bashkëkohore në punën dhe përpjekjet e tyre krijuese. Nëse do të kishte një reflektim të thellë nga ata që e kanë në dorë këtë punë, gjëja e parë që duhej t'u bëhej do të ishte pasurimi i bibliotekave të shkollave me librat më të mirë të këtyre poetëve dhe diskutimet krijuese rreth vlerave të tyre. Nuk do ishte keq që në të thirrjet herë pas here edhe ndonjë individualitet i njohur i kësaj fushe, ose studiues. Përsa i përket hartimit të teksteve shkollorë në të ardhmen, del si domosdoshmëri kërkesa që hartuesit e tyre të zgjidhen nga radhët e kritikëve dhe studiuesve më të mirë në vend, atyre që i njohin mirë rrjedhat dhe trendet e poezisë. Lënia e tyre në duar të amatorëve dhe botuesve profanë, është e gabuar dhe me pasoja afatgjata...



LUMTURIA E LIBRIT

(Ligjëratë e mbajtur nga autori me studentët e Universitetit të Belgranos, Buenos-Aires, 1977)

Jorge Luis BORGES

Në librin "Cezari dhe Kleopatra", Bernard Shaw thotë për bibliotekën e Aleksandrisë se ajo është kujtesa e njerëzimit. Por libri ka diçka më tepër. Ai është edhe imagjinata e tij. Sepse a nuk është e kaluara jonë një seri ëndrrash? Ç'ndryshim mund të ketë midis kujtoj ëndrrat dhe kujtoj të kaluarën. I tillë është funksioni që kryen libri. Njëherë kam menduar të shkruaja një histori të librit. Jo për pamjen e tij fizike. Nuk më intereson aspekti fizik i librave (sidomos i bibliofilëve që e teprojnë), por më interesojnë vlerësimet që janë dhënë për librin. Përpara meje e ka bërë Spengler-i tek vepra "Perëndimi i Oksidentit" ku ka ca faqe të mrekullueshme për librin. Duke u shtuar atyre ndonjë vëzhgim timin, unë kam ndërmend të mbetem në ato që thotë Spengler-i. Në lashtësi nuk e kishin kultin e librit si e kemi ne - dhe kjo nuk më befason; ata shihnin te libri një surrogat të fjalës së folur. Shprehja që përdoret shpesh. Scripta manent verba volant, nuk ka kuptimin që fjala është jetëshkurtër, porse që shkrimi ka diçka të ngurosur si vdekja. Në të kundërt, fjala ka diçka të lehtë, flatrore; diçka flatrore e të shenjtë, siç thotë Platoni. Është e çuditshme, por gjithë mësuesit e mëdhenj të njerëzimit kanë dhënë mësimë gojore.

Le të marrim rastin e parë: Pitagorën. Ne e dimë se ai e zgjodhi me vetëdije që të mos shkruante. Dhe këtë e bëri se nuk donte të ishte i lidhur pas fjalës së shkruar. Me sa duket ai e ndjente shprehjen që më pas do të thuhej edhe në Bibël: shkronja vret, shpirti ngjall. Prandaj Aristoteli nuk flet kurrë për Pitagorën, por për pitagorianët. Për shembull, ai thotë se pitagorianët jepnin mësim besimin, dogmën e kthimit të përjetshëm që Niçe do ta zbulonte shumë më vonë. Domethënë idenë e një kohe ciklike, e cila u hodh poshtë nga Shën Agustini te libri "Oqyeti i Zotit". Shën Agustini duke përdorur një metaforë të shkëlqyer thotë se Kryqi i Krishtit na shpëton nga labirinti qerthullor i stoikëve. Ideja e kohës ciklike ka qenë prekur edhe nga Hume-i, nga Blanqui e nga shumë të tjerë. Pitagora nuk shkroi në mënyrë të vullnetshme. Ai donte që mendimi i tij të jetonte përtej vdekjes së tij trupore, të mbijetonte në mendjen e nxënësve të tij. Nga kjo ka lindur formula që unë duke mos ditur greqisht do ta them latinisht: magister dixit. (e ka thënë mjeshtri). Kjo nuk do të thotë se ata qenë të kushtëzuar pas asaj që kishte thënë mjeshtri, përkundrazi me këtë ata vërtetonin se ishin të lirë të zhvillonin mendimin fillestar të mjeshtrit.

Ne nuk e dimë nëse doktrinën e kohës ciklike e ka shpikur Pitagora, por dimë se nxënësit e tij ua mësonin të tjerëve. Pitagora vdiq trupërisht dhe ata me një lloj transmigrimi që atij do t'i kishte pëlqyer, vazhduan t'i mësonin e t'i thellonin idetë e tij, aq sa kur i qortonin se duhej të thoshin gjëra të reja, mbroheshin me formulën: E ka thënë mjeshtri (Magister dixit). Mund të kujtojmë raste të tjera. Kemi shembullin e madh të Platonit kur thotë se librat janë si efizhitë (ai kishte parasysh mbase statuja apo tablo), që njeriu i pandeh të gjalla, por kur i pyet, ato, s'të përgjigjen. Dhe për ta korrigjuar këtë heshtje të librave, ai shpiku dialogun. Pra, Platoni vetë shndërrohet në personazhe të ndryshme: në Sokrat, në Gjorgjia e të tjerë. Mund të na shkojë në mendje edhe se Platoni donte të ngushëllohej për vdekjen e Sokratit, duke e përfytyruar të gjallë. Dhe çfarëdo problemi që t'i dilte, ai pyste veten: farë do të kishte thënë Sokrat për këtë. Ai që si të



thuash pavdekësia e Sokratit, që s'pati lënë asgjë të shkruar dhe ishte gjithashtu mjeshtër i fjalës së folur. Për Krishtin dimë se ka shkruar një herë të vetme ca fjalë mbi rërë e që u fshinë. Nuk dimë të ketë shkruar gjë tjetër. Edhe Buda ishte mjeshtër i të folurit; na ka lënë disa predikime. Pastaj, kemi edhe një frazë të Shën Anselmit, i cili thotë: "Të vësh një libër në duart e një injoranti, është po aq e rrezikshme sa të vësh një shpatë në duart e një fëmije". Ja pra se çfarë mendohej atëherë për librin. Në të gjithë Orientin ende gjallon ideja se qëllimi i një libri nuk është t'i zbulojë gjërat: një libër duhet thjesht të na ndihmojë për t'i zbuluar. Me gjithë paditurinë time në hebraisht, e kam studjuar pak Kabalën dhe kam lexuar versione anglisht e gjermanisht të Zoharit (Libri i Shkëlqimit) dhe të Sefer Jezirasë (Libri i Marrëveshjes). Unë e di se këta libra nuk janë shkruar për t'u kuptuar, por për t'u interpretuar, ata duhet ta nxisin lexuesin që të zhvillojë një ide.

Antikiteti klasik nuk e kishte respektin që kemi ne për librin edhe pse kemi mësuar se Aleksandri i Madh mbante nën jastëk "Iliadën" dhe shpatën, dy armët e tij. Ushqehet respekt për Homerin, megjithatë ai nuk shihej si shkrimtar i shenjtë, në kuptimin që ka sot kjo fjalë. Nuk mendohej se "Iliada" dhe "Odiseja" ishin tekste të shenjta; ato qenë tekste të vlerësosheshin, por edhe mund t'i kritikojë. Platoni i flaku poetët nga "Republika" e tij; gjithsesi pa u bërë i dyshimtë për herezi. Këtyre dëshmi të antikitetit kundër librit, ne mund t'u shtojmë një tjetër, shumë interesante të Senekës. Mes letrave të tij të pakrahasueshme drejtuar Lucillit, njëra i drejtohet një personi mendjemadh, për të cilin tregon se kishte një bibliotekë me njëqind vëllime; dhe kush - thotë Seneka - mund ta gjejë kohën për të lexuar njëqind vëllime. Ndërsa sot, përkundrazi, çmohen bibliotekat e mëdha. Pra, në antikitet për librin ka një qëndrim që mezi e kuptojmë, që nuk ngjason me kultin që kemi ne për librin. Te ky i fundit shihej përherë një surrogato e fjalës. Por më pas nga Orienti vjen një koncept krejt i panjohur për antikitetin klasik: Koncepti i librit të shenjtë. Do të marrim dy shembuj duke filluar nga më i vonshmi, nga ai i myslimanëve. Ata mendojnë se Kurani i paraprin Krijimit dhe është më i mocëm se gjuha arabe. Kurani, thonë ata, nuk është vepër e Zotit, por njëra prej vetive të tij, siç janë mëshira apo drejtësia. Aty flitet në një mënyrë të

pabesueshme për mëmën e librit. Mëma e librit është një kopje e Kuranit të shkruar në qiell. Shkurt, ai është arketipi platonian i Kuranit, dhe ky libër është shkruar në qiell, thotë Kurani - si atribut i Zotit, e për më tepër është më i hershëm se Krijimi. Këtë gjë e thonë edhe ulemat apo doktorët myslimanë.

Por çfarë është kjo, krahasuar me një libër të shkruar nga Shpirti, krahasuar me konceptin e Hyjnisë që zbrit në letërsi dhe dikton një libër. Në një libër të këtillë asgjë s'mund të jetë e rastësishme, asgjë, deri edhe zgjedhja e shkronjave duhet ta ketë një arsye. Me këtë logjikë e kuptojmë, përse fillimi i Biblës, Bereshit baraelohim është me B, sepse kjo i përgjigjet fjalës bekoj. Fjala është pra, për një libër, në të cilin kurrëgjë nuk është e rastësishme, absolutisht asgjë. Mbërrijmë kështu te Kabala, tek studimi i shkronjave, te një libër i shenjtë i diktuar nga Hyjnia, domethënë në të kundërt të asaj që mendonin të vjetrit. Ata mendonin për muzën në një mënyrë mjaft të vagëlluar. Këndo, muzë, zemërimin e Akilit, ("Këndo hyjneshtë, mëninë e Akil Pelidit", është përkthim i shkëlqyer i Gjon Shllakut, por ky përkthim fjalë për fjalë, me varfëri semantike këtu bëhet, sepse ka një koment lidhur me fjalën muzë. Shën i përkth.) thotë Homeri në krye të Iliadës. Këtu muza përfaqëson frymëzimin. Po të mendojmë Shpirtin, pranojmë diçka më konkrete e më të fuqishme: Zotin që është brenda letërsisë. Zotin që shkruan libër, në të cilin gjithçka arsyetohet: numri i shkronjave, i rrokjeve, i vetseteve, ku bëhet lojë fjalësh me shkronja, të cilat tashmë i kemi studiuar. Ideja e dytë e madhe që kemi për librin, është se ai, po e përsëris, mund të jetë vepër hyjnore. Sigurisht kjo ide është më afër asaj që kemi sot për librin se ajo e lashtësisë që e vështron librin si një surrogato të fjalës së folur. Pastaj besimi në një libër të shenjtë humbet dhe zëvendësohet prej besimeve të tjera. Ekziston bindja, për shembull, se çdo vend njëjtësohet me një libër. Duhet të kujtojmë këtu se myslymanët i quajnë izraelitët njerëz të Librit, le të kujtojmë gjithashtu atë që ka thënë Henri Heine në lidhje me kombin, atdheu i të cilit ishte një libër Bibla, çifutët. Dhe lind kështu ideja e re, sipas së cilës çdo vend duhet të përfaqësohet nga një libër, apo nga një autor që mund të ketë shkruar shumë libra.

Është e çuditshme - dhe nuk besoj se ky fakt është vënë re deri tani - por vendet

kanë zgjedhur individë që nuk u ngjajnë shumë. Dikush, për shembull, mendon se Anglia mund të kishte zgjedhur Samuel Johnson-in, por ajo ka zgjedhur Shekspirin dhe Shekspiri është si të thuash - më pak anglezi ndër shkrimtarët anglezë. "Understatement-i, pra, është karakteri tipik i anglezitet. Por Shekspiri prirej ndaj hiperbolës në metaforë dhe nuk do të habiteshim fare nëse ai do të kishte qenë italian apo çifut. Kështu ka ndodhur edhe me Gjermaninë, ky vend i bukur fanatik për hiçgjë, zgjodhi pikërisht një njeri tolerant, aspak fanatik, të cilit nuk i intereson shumë nocioni atdhe, pra zgjodhi Gëten. Gjermania përfaqësohet nga Gëte.

Në Francë nuk është zgjedhur ndonjë, por ka një dobësi për Hygoïn. Natyrisht, unë ushqej një admirim të madh për Hygoïn, por Hygoi nuk është francez tipik. Hygoi është i huaj për Francën: me dekorat e tij të mëdha e me metaforat e panumërta, ai s'është përfaqësues i Francës.

Edhe më i habitshëm është rasti i Spanjës. Ajo mund të përfaqësohet nga Lope De Vega, nga Calderon, nga Quevedo. E pra, jo! Nuk ndodhi ashtu! Spanja përfaqësohet nga Migel de Servantes. Servantesi është bashkëkohës i Inkuizionit, por është një njeri tolerant që nuk zotëron as virtytet dhe as cenet e spanjollëve. Ngjason sikur çdo vend mendon se duhet të përfaqësohet nga dikush që ndryshon prej tij, nga dikush që mund të jetë si një lloj bari shërues, një lloj opiumi, një kundërhelm ndaj të metave. Ne argjentinasi, mund të kishim zgjedhur "Fakundon" e Sarmientos, që është libri ynë, por jo; me historinë tonë ushtarake, me historinë e betejave, ne kemi zgjedhur si libër kronikën e një dezertori, kemi zgjedhur librin "Martin Fierro", që padyshim meriton të zgjidhet, por si mund të mendohet që historia jonë të përfaqësohet nga një dezertor i pushtimit të tokave? Gjithsesi kështu është: çdo vend duket se provon mbëhinë e kompensimit.

Për librin janë shkruar faqe të ndritura nga shumë shkrimtarë. Do të doja të citoja ndonjërin prej tyre. Po e nis me Montenjin, i cili një nga esetë e tij ia kushton pikërisht librit. Në këtë ese ka një frazë të tillë, të paharrueshme. "Unë nuk bëj asgjë pa gëzim". Montenji lë të kuptohet se koncepti i të lexuarit me çdo kusht, është një koncept i gabuar. Ai thotë se kur has ndonjë pjesë të vështirë në një libër, ai e lë, sepse akti i të lexuarit është një formë

e lumturisë. Më kujtohet se para shumë vitesh u bë një anketë ku pyetej se çfarë shpreh piktura. E pyetën motrën time, Norën, dhe ajo u përgjigj se piktura ishte arti që dhuron gëzim me forma dhe ngjyra. Unë do të thosha se edhe letërsia është një formë e këtij gëzimi. Nëse diçka lexohet me vështrësi, autori nuk e ka përmbushur misionin e vet. Ja përse unë mendoj se një shkrimtar si Xhojsi në thelb e ka harruar misionin, sepse vepra e tij lyp mundim për ta lexuar.

Një libër nuk duhet të kërkojë mundim, sepse lumturia nuk duhet të kërkojë mundim. Më duket se Montenji ka të drejtë. Pas kësaj ai numëron autorët që ka për zemër. Përmend Virgjilën dhe pohon që më shumë pëlqen "Gjeorgjikat" se "Eneidën". Unë për vete pëlqej "Eneidën", por s'është këtu çështja. Montenji flet me pasion për librat dhe thotë se librat janë një kënaqësi e ngadaltë... Duke patur kultin e librit, unë vazhdoj të bëj sikur nuk jam i verbër, vazhdoj të blej libra e të

mbush shtëpinë me to. Një ditë më parë më bënë dhuratë një botim të vitit 1966 të Encyclopedie de Brockhaus. Dhe e ndjeva praninë e kësaj veprë në shtëpi, e kam ndërë si një lloj lumturie. I kisha pranë meje të njëzet vëllimet me shkronja gotike, të cilat nuk mund t'i lexoj, plot harta dhe gravura që nuk mund t'i shoh: por sidoqoftë vepra ishte aty. Provoja një si tërheqje miqësore. Kam mendimin se libri është një nga lumturitë e mundshme të njeriut. Sot flitet për zhdukjen e librit: mua më duket se kjo është e pamundur. Do të më thonë se cili është ndryshimi mes një libri dhe një gazete apo një disku? Ndryshimi është ky: një gazetë lexohet për t'u harruar edhe disku dëgjohet për t'u harruar, është një gjë mekanike dhe kuptohet që është e përkohshme. Porse një libër lexohet për t'u kujtuar.

Koncepti i një libri të shenjtë, si Kurani, si Bibla apo Vedat - që shkruajnë se edhe ato e kanë krijuar botën - është ndoshta i tejkaluar, por libri ruan përherë një shen-

jtërim, të cilin duhet të përpiqemi të mos e humbim. Të marrësh një libër e ta hapësh, e bën edhe më të mundshëm faktin estetik. Cilat janë fjalët që flenë në libër? çjanë ato simbole të vdekura? Krejtësisht asgjë. I farë është një libër që nuk e hapim? Është thjesht një kub letre apo lëkure, me fletë; por nëse e lexojmë do të ndodhë diçka e çuditshme. Dhe besoj se libri ndryshon sa herë që e lexojmë.

Herakliti thotë (e kam përsëritur shpesh) se njeriu kurrë nuk lahet dy herë në të njëjtin lumë. Ne nuk lahem kurrë në të njëjtin lumë, sepse ujërat e tij ndërrojnë. Akoma më e tmerrshme është se edhe ne jemi ujorë si lumi. Sa herë që lexojmë një libër, aq herë ndryshon ai, ngjyrimi i fjalëve nuk është i njëlojtë. Sepse librat janë mbrujtur me të shkuar.

Kam folur kundër kritikës dhe po e përgënjeshtroj veten (ç'rëndësi ka që përgënjeshtrohem?). Hamleti nuk është saktësisht ai Hamlet që krijoi Shekspiri në


fillimet e shek. XVII; Hamleti është Hamleti për të cilin flet Kollrixhi, Gëteja dhe Bredli. Hamleti është rikrijuar. E njëjta gjë ka ndodhur me Don Kishotin. Kjo mund të thuhet edhe për Lugones apo Martinez Estrada. "Martin Fierro" nuk është më ai që ka qenë. Lexuesit pak nga pak e kanë pasuruar librin. Kur lexojmë një libër të hershëm, është njëlojtë si të përshkonim kohën që ka kaluar që nga çastet kur ai është shkruar e deri në ditët tona. Ja përse duhet të kemi kultin e librit. Një libër mund të jetë plot gabime shtypi, ndodh edhe që të mos jemi dakort me atë që thotë autori, por libri ka diçka të shenjtë dhe hyjnore. Nuk duhet ta respektojmë atë, të shtyrë nga bestytëria, por me dëshirën e madhërishme që të kridhemi në lumturi e në dije. Kjo është ajo që doja t'ju thosha sot.

Përktheu nga frëngjishtja Feride Papeka

Takimi me poetin e shquar, Janis Ricos

POEZIA DHE LIRIA

Ai më nguli sytë e ndritshëm, u ngrit në këmbë duke më marrë dorën mes duarve të tij, pastaj mori librin në dorë dhe më tha; - po, ju shqiptarët ishit nga të parët që përkthyet librin tim



Luan ZUKA

Ishte viti 1985 ku në stadiumin e Lojërave me Dorë të Selanikut "Aleksandrio Melathro", do zhvillohej një takim me poetin idhull të rezistencës greke ndaj nazistëve dhe juntës ushtarake. Ne, studentët, ishim shumica mes mijëra vetëve në atë sallë, kur kumbonte zëri i thekshëm i Ricosit, duke recituar poezitë e tij me atë theks grykor të "r-së", dhe kori i zërave tanë që e shoqëronin në një atmosferë magjike, ku në vend të ajrit kishte vetëm tinguj dhe fjalë...Ishte fuqia jetëdhënëse e poezisë.

Pas mbylljes së takimit, njerëzit u dyndën për ta takuar Ricosin. Ai, ashtu trup vogël, i qeshur, qëndronte ulur në cep të tavolinës

duke u dhënë dorën njerëzve. Erdhi edhe radha ime. Radha për t'u takuar me historinë e poezisë; isha para atij që Palamas i kishte thënë "të hapim rrugën, poet". Më dukej se aty ishte ulur edhe Majakovski, edhe Neruda, edhe Nazim Hikmet...

I humbur në përsiatje, u kujtova se në dorë kisha librin e tij të parë të përkthyer në shqip "Mëshallat e botës" nga Spiro Çomora më 1961.

- Jam nga Shqipëria, i thashë me zë të dridhur, ja libri i juaj i parë i përkthyer në shqip.

Ai më nguli sytë e ndritshëm, u ngrit në këmbë duke më marrë dorën mes duarve të tij, pastaj mori librin në dorë dhe më tha; - po, ju shqiptarët ishit nga të parët që përkthyet librin tim. Pastaj ngriti kokën me vështrimin

hedhur tek njerëzit përreth dhe foli me zë të lartë "u dedikohemi shumë shqiptarëve (οφειλούμε πολλά στους Αλβανούς...)". U ul përsëri, dhe me zërin e tij të ngadaltë po më përmendte lidhjet historike të dy popujve tanë. Unë i thashë disa vargje në shqip nga poezia e tij "Pse kemi faj?", duke i thënë në mënyrë metaforikë për mungesën e lirisë në Shqipëri, por pa guxuar t'i tregoj se kishte vite që regjimi i vendit tim nuk lejonte qarkullimin e poezive të tij. Nuk desha ta lëndoj.

Pas disa vitesh, në tetor të vitit 1990, në lajmet e mbrëmjes së radios së Athinës, dëgjoj lajmin e vdekjes së Janis Ricosit. U pikëllova, dhe ndjeva një peng që nuk kisha përkthyer poezitë e tij në shqip. U ula, dhe gjithë natën përktheva disa poezi të cilat ditën ia dhashë Bardhyl Londos për t'i botuar tek gazeta "Drita", duke i treguar edhe për takimin me Ricosin.

I kërkova patjetër t'më botonte poezinë "Pse kemi faj?".

Gazeta "Drita" dilte vetëm të dielave, dhe të nesërmen, të hënën, një student poet M.M., në orën e leksionit tim, ua tregon studentëve faqen e gazetës me poezitë e përkthyer nga unë. Mund ta lexosh, i them.

Ai pasi i lexoi më thotë, t'i lexoj përsëri dy vargjet e fundit?

Pa prituri përgjigje nga unë, i recitoi me zë të lartë:

"Dhe unë ç'faj kam të eci mes natës i lidhur pas lirisë sime duke dënuar? - i dënuari tha"

Duartrokijte nga studentët. Ishte 19 tetor 1990.

Edhe në Shqipëri po frynte era e lirisë. Para studentëve qëndroja unë pedagogu, poeti M.M me gazetën e hapur, dhe atmosfera që po shqyey nga një rini e etur për LIRI. Por çfarë lirie? Çfarë kuponin më lirinë studentët e mi të rritur ndrydhshëm në një kohë kur ishte ndaluar të flisje për lirinë e njeriut?

-Çfarë kuponin me konceptin "liri"? pyeta unë.

U ngrit një student - të lirohet ai i dënuari, tha, ai që kujton se është i lirë.

U ngrit një tjetër - unë dua të jem i lirë të shkoj jashtë shtetit, sepse me ato që shikoj në televizor, më duket se jetoj në planet tjetër.

"U prish" ora ime e leksionit, duke vazhduar bisedën për lirinë. Gjatë viteve të ngurta ishin mbledhur kaq shumë dëshira për liri, ku secili e shpjegonte dhe e donte lirinë sipas perceptimit dhe halleve të jetës së tij, sa mua më dukej se shqiptarët pasi të dilnin në liri, nuk do dinin se çfarë të bënë me atë.


Megjithatë, unë isha me idenë e Hayek se "liria është e rëndësishme, sepse pikërisht nuk e dimë se si do e përdorin njerëzit", por megjithatë historia e ka vërtetur dobinë e saj për njerëzimin.

Qoftë edhe "të dënuar pas lirisë", siç e thotë poeti...

(Autori në vitet 1981-1987 ka qenë student në Universitetin "Aristotel" të Selanikut)

KISHA NJË DËSHIRË, TË DESHIFROJA ERRËSIRËN QË MË KAFSHONTE SHPIRTIN

Ia vlen t'i kushtohet jeta shkrimit. Se librat edhe pas ikjes sonë nga kjo botë mbeten gjallë, përveç atyre që kanë lindur të vdekur dhe lëvizin poshtë e lart, të tjerët e kanë jetën e tyre



Bisedoi: Zyrafete SHALA

Qysh në takimin e parë me Xhevdet Bajrajn isha e vetëdijshme se njohja me te ishte nga ato befasishtë që jeta rrallëherë na i ofron. Nuk duhej shumë kohë për të kuptuar se madhështia e tij si poet, që e kisha njohur më parë, njëjtësohej natyrshëm me virtytet njerëzore e intelektuale të mishëruara në personalitetin e tij. Horizonti i gjerë i njohurive nga letërsia botërore e kombëtare, pikëvështrimi unik i perceptimit dhe interpretimit të artit, krahas dhuntisë për të konceptuar dhe shprehur thellësinë e poezisë në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë ishin të pazakonta për mjedisin tonë. Këtu zuri fill edhe ideja ime që të nisim një projekt të përbashkët, një libër në formë të bashkëbisedimit rreth çështjeve thelbësore të poezisë dhe letërsisë në përgjithësi. Mirëpo, ky projekt u ndërpre qysh në fazën e parë, nga sëmundja e tij. Pengu për projektin e ndërpreur dhe ndjenja e fajësisë që nuk isha kujtuar më herët për të, u

bënë shtytje për ta botuar këtë intervistë dhe për t'u ofruar edhe të tjerëve kënaqësinë e leximit të saj.

Poeti amerikan Carl Sandburg e definon poezinë si "Ditar i një kafshe detare, që jeton në tokë dhe do të dëshironte të fluturojë" një përkufizim ky tejet interesant për poezinë dhe poetin, por jo edhe i vetmi. Secili poet ka një koncept vetjak për poezinë, prandaj një pyetje që jo rrallë u bëhet poetëve, dhe natyrisht u është bërë edhe juve në shumë intervista, është se çfarë paraqet poezia për juve? Megjithatë e vlerësoj të rëndësishme ta përsërisim këtë pyetje dhe t'i dëgjojmë përgjigjet tuaja, sepse jo vetëm që relacioni juaj me poezinë është shumë i veçantë, por edhe për faktin që në mjedisin tonë shpeshherë po harrohet misioni i poezisë.

- Për mua jeta është poezi, apo poezia është jetë, kështu që gjithmonë e kam vëmendjen e përqendruar në librin që po e shkruan

jeta për momentin në këtë botë, sidomos në kapitujt që kanë të bëjnë me Ballkanin dhe me viset shqiptare. Poezi është dashuria, ajo që i jep kuptim asaj vizës në mes të ditës së lindjes dhe ditës së vdekjes. Ky është versioni optimist, se përndryshe poezi është vetë ajo vizë, edhe pa dashuri. Po të mos botonin njerëzit që nuk dinë të shkruajnë, do ta shijonim pakëz më shumë qetësinë, sigurisht se do të kishte më shumë mirë, e të tjera, e të tjera. Jam i bindur se poezia ka turp për shumicën absolute të poetëve të sotëm, ashtu siç turpërohet edhe liria nga ata që e keqpërdorën.

Poezia juaj është thellësisht e preokupuar me realitetin kosovar, madje ju arrini ta njihni çdo pore të jetës në Kosovë, sikur të jetonit vazhdimisht këtu. Për më tepër, preokupimet tona i vishni me petkun universal të shqetësimeve të njeriut mbi botën. Megjithatë, jashtë poezisë në përgjithësi keni zgjedhur të jeni i

kursyer në deklaratat politike; e kur rrallë ndonjëherë shfaqni më hapur mendimin rreth njërit apo tjetrit subjekt politik, disa nga adhuruesit e poezisë tuaj ju japin 'këshilla' rreth qëndrimit që duhet të ketë poeti dhe për vendin e tij në shoqëri. A mendoni se poeti duhet të jetë i angazhuar?

- Arsyeja e vetme pse ekziston letërsia është sepse për krijuesin është i pamjaftueshëm realiteti, pavarësisht se çfarë realiteti është ai, ashtu siç është e pamjaftueshme edhe jeta me tërë kompleksitetin që ajo ka. Unë shkruaj poezi për t'u mbrojtur nga jeta, nga dhimbjet që më shkakton ajo; shkruaj sepse nuk më pëlqen realiteti. Meqë nuk mund ta ndryshoj atë, atëherë përpiqem të mbrohem nga ai përmes artit, përmes poezisë. Periudha nëpër të cilën po kalojmë aktualisht ne si popull, ka nevojë për vështrimin kritik të poetit, realiteti ynë ka nevojë të shohë imazhin e vet në poezi. Ata që mendojnë se janë poetë, por që qëndrojnë në margji-

na të jetës së njeriut apo të kombit, me plot bindje them se të njëjtit ende nuk e kanë kuptuar se çfarë është poezia.

Si filloi bashkëjetesa juaj me poezinë? Kush ishte 'fajtori' që ju bëri bashkë juve dhe poezinë?

- E kam thënë edhe herëve të tjera se ishte Charl Bodlerit me "Lulet e së keqes". Isha shtatëmbëdhjetë vjeç, i zhytur deri në fyt në lllumin e jetës... dhe lulet e Bodlerit ishin fija e kashtës sime të shpëtimit. U kapa për të, kisha fat, qëllimi ishte fije e Kashtës së Kumtrit dhe kështu e mora Udhën e Qumështit (qumështi ishte herë me sheqer, herë pa të). Kur fillova të shkruaj, nuk po mendoja për lexuesit apo për suksesin, thjesht më duhej të hiqja një peshë që më merrte frymën. Dëshira ime e vetme ishte të mund të deshifroja errësirën që më kafshonte shpirtin. Ndërsa pak më vonë, kur isha njëzet vjeç, lexova për herë të parë "Mitin e Sizifit" të Albert Kamysë që mendoj se ka ndikuar fuqishëm në formimin tim. E kisha përshtypjen që ishte një dritare që përveç që ma mundësonte ta shoh botën, ma mundësonte të shoh edhe brenda vetes. Romanin e tij "I huaji" e pata lexuar kur isha në klasën e pestë apo të gjashtë të shkollës fillore dhe natyrisht që fare nuk e kisha kuptuar. E rilexova, tashmë i kontaminuar me filozofinë e

"absurditetit" dhe më pëlqeu tej mase. E futa brenda thonjëzave fjalën absurditet, sepse kurrë nuk më ka dhuruar këtë ndjenjë leximi i veprave të Kamysë.

Mendoj se prapa një poeti të mirë duhet të qëndrojë gjithsesi një lexues i mirë, këtë në njëfarë mënyre e thotë edhe Borges. Si ka qenë raporti juaj me librin në përgjithësi, a lexoni shumë dhe çfarë po lexoni aktualisht?

Është e vërtetë se prapa një poeti dhe prapa një poezie ka shumë punë, shumë lexime. Vetë natyra e punës së artistit na imponon edhe leximin, qoftë poezi, rrëfim, filozofi apo histori. Aktualisht po lexoj "Poezi, një histori e të çmëndurve (1962-1986)" apo në gjuhën spanjolle: Poesía, una historia de locos (1962-1986), antologji e poetit të shkëlqyeshëm bashkëkohor peruan, Antonio Cisneros. Për të qenë i saktë, nuk jam duke e lexuar, por sapo e lexova. Përndryshe, java nuk më kalon pa lexuar shtatë a tetë libra me poezi dhe ese të shumtë rreth letërsisë. Këtë semestër jam duke e ligjësuar lëndën Poezi I dhe Poezia bashkëkohore meksikane, kështu që më bie të lexoj dhe të rilexoj shumë. Tani kam në plan të filloj me ndonjë nga librat e pabotuar të miqve të mi meksikanë që presin për t'iu dhënë një mendim

kritik apo për t'i vlerësuar.

Pohuat se Bodleri me "Lulet e së keqes" dhe Kamy me "Mitin e Sizifit" u ka ndryshuar në njëfarë mënyre orientimin në jetë. Çka mund të thoni për librat e tjerë që keni lexuar më pas? A ka pasur ndonjëri prej tyre forcën që të ju ndryshojë botëkuptimet mbi jetën, mbi artin? Apo së paku a ka pasur sadopak ndikim në krijimtarinë tuaj?

- Në fund të viteve '80 më ra në dorë një antologji e poezisë spanjolle, i kishte kopertinat e kuqe, i njihja disa poetë që ishin të përfshirë brenda saj, por jo edhe Miguel Hernándezin. Aty e lexova poezinë e tij Ninullat e qepës dhe mbeta pa frymë. Ishte një menaxhim brilant i emocionit. Në atë kohë e kisha të botuar librin tim të parë, "Nënë prej guri", që iu bashkëngjiti propozimit estetik që mbretëronte në Kosovë në fund të viteve, kështu që duke iu falënderuar kësaj poezie dhe Miguel Hernandezit, poezia ime ndryshoi përgjithmonë. Megjithatë, do ta përsëris atë që e kam thënë edhe në një rast tjetër se: nuk janë Bodleri dhe M. Hernándezi poetët e mi të preferuar, po ashtu, nuk është poezia në fjalë poezia ime favorite e Hernándezit, vetëm po kthehem në kohë dhe po rrëfej për atë efektin që kanë pasur ato poezi në krijimtarinë time.

Nga përvoja juaj me librin, a mendoni se çdo libër e ka kohën e vet të leximit dhe se duhet lexuar çdo libër që të bie në dorë?

- Paj, ka diçka të vërtetë në këtë që thoni, por i njëjti libër ka efekt të ndryshëm te njerëzit e së njëjtës moshë, prandaj kohën e leximit e cakton secili lexues për vete, pavarësisht se çdoherë nuk mund t'i bëjë llogaritë si duhet. Ndoshta unë do të kisha dashur që disa libra t'i kisha lexuar më herët, e disa më vonë, por tanimë ajo ka kaluar. Me rëndësi është që sot të gjithë e kanë qasjen më të lehtë tek libri, gjithashtu me rëndësi është të mësohet ndonjë gjuhë e madhe e botës që të komunikohet me sa më shumë shkrimtarë. Në anën tjetër, ka aq shumë libra që kurrë s'do të dëshiroja t'i kem lexuar. Por, është dashur ta bëj këtë, jetë i thonë kësaj, është detyrë e shkrimtarit ta gjejë veten në botën letrare, ta gjejë atë që i përket të shkruaj. Nëse e arrin këtë, atëherë mund të fle zbatuar, se edhe po të ngriheshin nga varri kolosët e letërsisë botërore nuk do të mund të shkruanin më mirë se ai, për arsye të thjeshtë, se vetëm atij dhe askujt tjetër i ka takuar ta bëjë këtë. Dikush mund ta quajë këtë: origjinalitet, le t'i thotë si t'ia ka ëndja, pa u arritur kjo, e tëra është e kotë. Pavarësisht çmimeve letrare, rrethit letrar apo letërsisë që i përket.





Më rastis shpesh të lexoj intervista me shkrimtarë bashkëkohorë shqiptarë dhe kur i pyesin se cilët libra apo cilët autorë u preferojnë lexuesve, ata shpesh përmendin dy tre miq dhe titujt e librave të tyre. Mbase ndonjëherë këto preferenca edhe mund të jenë korrekte, por jo gjithmonë. Imagjinoni një adoleshent të pasionuar që lexon intervistën dhe efektin që arrijnë tek ai ato propozime!! Çfarë u preferoni ju lexuesve?

- Mund të them së pari çfarë më intereson mua të lexoj. Unë jam i orientuar të lexoj autorë, poezia e të cilëve përpiqet t'u përgjigjet problemeve ekzistenciale me të cilat u përballën gjatë jetës. Është ky një udhëtim në kohë, një aventurë që na bën të kuptojmë se brezat kanë të përbashkët diçka tragjike. Duhet lexuar libra që hapin shtigje të reja, apo që përpiqen ta bëjnë një gjë të tillë, libra të sinqertë, që i ngjajnë mesazhit në shishe të nisur nga udhëtari i anijes së fundosur e që ka përfunduar në një ishull. Në të vërtetë, shkrimtari është udhëtari i anijes së mbytur. I rekomandoj të rinjve që duan të bëhen shkrimtarë, ose që tashmë janë të tillë, të lexojnë veprat e plota të autorëve të tyre të preferuar. Për shembull, nëse lexohet Balzaku i ri dhe Balzaku i pjekur do të shohim se si funksionon një shkrimtar i madh. Madhështia është në përgjigjet e ndryshme që ai u jep pyetjeve gjatë evoluimit të tij. Studentët e

mi zakonisht i këshilloj t'i lexojnë veprat e plota të poetëve si Villaurrutia, Blas de Otero, Luis Cernuda, Borges, Neruda... Ndërsa miqve meksikan u dhuroj zakonisht libra të Kadaresë, Kongolit, Kazantzakis, Tonino Guerra e tjerë, që do të thotë se në njëfarë mënyre ua preferoj t'i lexojnë.

Rrugëtimin në botën e poezisë e keni filluar në gjuhën shqipe, për ta vazhduar më tej në gjuhën e një sërë kolosëve të letërsisë, në atdheun e realizmit magjik. Si mund ta thoshit me pak fjalë këtë përvojë tuajën të veçantë?

Diku në një intervistë në spanjisht e kam bërë një ilustrim të gjendjes sime dhe po përpiqem ta përsëris për afërsisht edhe këtu. Është sikur të jem një peshk që jeton në dy lumenj, një peshk që u plagos në luftën e Kosovës/Ballkanit. Unë erdha me atë plagë në këtë det, ajo plagë po gjakoste ende dhe në lumin ku jetoj tani kam vënë gjakun tim. E gjithë përpjekja ime në Meksikë, ka qenë për ta përkthyer në spanjisht atë gjak dhe atë dhimbje. Meqë disa lumenj derdhen në dete, ai gjak tanimë është përzier me plagët e Amerikës Latine. Nëse nuk do ta zotëroja gjuhën, nuk do të arrija t'i përkthej plagët e mia. Gjuha është mjeti i zërit, i kockave, i mishit dhe i shpirtit njerëzor. Megjithatë, për poetin është e rëndësishme poezia, jo gjuha në të cilën është shkruar ajo.

Shumë kohë më parë më pat bërë përshtypje një mendim i Lasgushit për artin, ku thotë se arti nuk ka shkallë të dytë. Sipas tij, arti është i vetmi manifestim shpirtëror i brendshëm, i veshur me formën e jashtme të fjalës, i cili nuk pranon gradacione. A e mbështesni edhe ju këtë mendim kur bëhet fjalë për poezinë?

Poezia është ose nuk është, nuk ka një fazë të ndërmjetme, kur diçka i ngjan poezisë dhe është në zhvillim e sipër, mund edhe të flitet për te, ama nuk është poezi.

Duke qenë krijues dhe ligjërues i poezisë në një gjuhë e kulturë që i ka ofruar botës aq shumë kryevepra, si e shihni letërsinë/poezinë e dy dekadave të fundit në Kosovë?

- Mua më dhemb Kosova kur gjendem atje, më dhemb edhe mungesa e saj (kur jam këtu, në Meksikë), dhe si çdo gjë tjetër në Kosovë edhe letërsia më dhemb. Sigurisht do të më pyesni pse? Po përpiqem ta bëj një ilustrim: Imagjinoni se keni dalë në një treg dhe te çdo shitës që ofroheni gjeni mallra të përgjysmuara; një kukull pa njërin dorë, pa sy, apo pa asnjë gjymtyrë, vetura të vogla që u mungojnë gomat, topa të shfryrë që nuk kërcejnë e të tjera të ngjashme, dhe për të gjitha këto t'i dëgjoni lavdërimet e shitësve, qoftë për mallin e vet, apo për ato të shitësve të tjerë, të shihni kë-

aqësinë dhe mburrjen e tyre për ato që u ofrojnë klientëve. Në anën tjetër ju ruani në kujtesë pamjen e tregut të para disa dekadave kur mallrat ishin të një cilësie të lartë, por nëse provoni t'ua thoni këtë shitësve, ata jo vetëm që nuk ju kuptojnë, por ju shohin si mendjemadh e ju veshin lloj-lloj etiketash.

Nëse hedhim një vështrim retrospektiv në krijimtarinë tuaj në gjuhën shqipe, duke filluar nga viti 1988 ("Nënë prej guri", Rilindja) e deri më sot, shohim se gjatë këtij harku kohor tridhjetë e tre vjeçar, keni arritur të krijoni portretin gjithëpërfshirës të ndjenjave më sublime të njeriut, portretin e dhimbjes, trishtimit, mallit e dashurisë, krahas hartografisë së vuajtjeve të popullit tonë. Cili nga librat tuaj të botuar deri më tani është më i dashuri për ju dhe me të cilin dëshironi të identifikoheni si poet?

- Po ta kisha përgjigjen në këtë pyetje me siguri nuk do të shkruaja më. Për momentin parapëlqej që kjo t'i ndodh librit të radhës "Unaza e Saturnit". Pasi të botohet ky, të njëjtën ndjenjë do të ma jepte libri i radhës. Prandaj edhe ia vlen t'i kushtohet jeta shkrimit. Se librat edhe pas ikjes sonë nga kjo botë mbeten gjallë, përveç atyre që kanë lindur të vdekur dhe lëvizin poshtë e lart, të tjerët e kanë jetën e tyre.

TEKI DËRVISHI DHE LOJA E TIJ

Teki Dërvishi është i lidhur ngushtë me teatrin dhe këtë mund ta identifikosh në çdo tekst të tij. Çdo pamje që na jep duket se procesin e krijimit e kalon në syrin e autorit nëpërmjet një inskenimi imagjinar në skenë teatri

Adriatik ZEÇIRI

Teki Dërvishi është mjeshtri brilant i fjalës së shkruar. Ai krijimin e tij e përjeton si lojë. Lojë e fjalës së thënë, lojë e figurimit të fjalës, lojë retorike pambarim, lojë e ideve që lindin, jetën si lojën e madhe njerëzore. Diskursi i tij është në funksion të lojës shprehëse të tij, të nevojës aq të madhe të artistit për të treguar dhembjen e tij. "E, Teki Dërvishi është poet. Ky edhe është gjakimi i tij. Çfarë tjetër do të ishte gjakimi i njeriut që fatkeqësinë personale e vë në lojë pandërprerë, në lojën e vetme që e njeh, në lojën e shkrimit letrar."

Në strukturimin e tekstit është shumë i mirë, duke i ngërthyer zhanret njërin në tjetrin. Pra diskursi e tij dhe zhanret shpeshherë nuk janë nga ato klasiket. Dalin përtej duke krijuar kështu strukturime të reja zhanrore. Në interpretimin që i kemi bërë romanit PIRGU I LARTË kemi konstatuar që, për nga forma është roman, por nga diskursi është tragjedi, pra një kombinim zhanresh që deri në kohën sa është shkruar romani PIRGU I LARTË nuk kishte në letërsinë shqipe diçka të tillë. Njëjtë ndodhë që strukturat retorike të dramës, të i shohim në romanin Herezia e Dërvish Mallutës, apo pastaj te kalimi tek zhanri fiksional i biografisë, siç është Palimpsest Dush Kusarit. Pra shkrimi i Teki Dërvishit është modern, përveç që i njeh format, ka tendencë që të krijojë forma të reja, ose më saktë të shtrihet në format e eksploruar deri në atë kohë. Po themi kështu ngase qëndrojmë në bindjen se zhanret janë aty për t' u shfaqur gjithmonë siç

konstaton edhe Todorov te Origjina e zhanreve: "Ajo që është edhe më domethënëse është fakti se libri si tërësi është i bazuar në distinkcionin midis mënyrave fundamentale, narratives dhe romanit: mënyra narrative karakterizohet nga kërkimi këmbëngulës për origjinën e saj - të cilën mënyra e romanit e zhduk dhe e përjashton. Prandaj "zhanri" si i tillë nuk është i zhdukur; zhanret e së kaluarës thjesht janë zëvendësuar nga të tjerat. Ne më nuk flasim për poezinë dhe prozën, për dokumentarin apo fiksionin (tregimin), por për romanin dhe narracionin, për mënyrën e narracionit dhe për mënyrën e diskursit, për dialogun dhe shënimet. Fakti se vepra e "tradhton" zhanrin e vet, nuk do të thotë se zhanri nuk ekziston."

Një "ngatërrim" zhanror e kemi në prozën e Teki Dërvishit dhe ky është edhe rezultati i lojës së tij, nevojës së pashmangshme të tij për të shprehur më shumë, po gjithmonë duke qenë i mbuluar nga figura, një metaforë e tejzgatur. Disa autorë te proza e Teki Dërvishit do të identifikonin të ashtuquajturën prozë poetike. Bile Sabri Hamitit do të ketë gjetjen si proza lirike, duke dhënë edhe një shpjegim: "Proza lirike është përherë e orientuar nga të ndriçuarit e anëve psikike të njeriut dhe i detyrohet botës së brendshme të individit. Duke u marrë me këtë sferë të interesimit të saj nga bota e brendshme e njeriut na imponohet një mendim. Njeriu nuk krijohet, formohet vetëm me praninë e rrethanave të jashtme, konkrete dhe të shpjegueshme. Ajo që thelbësisht ndikon në fatin e tij janë forcat që përcaktojnë qenien e tij

individuale, të brendshme, të ndërjshme dhe irracionale, të pamatshme. Pra, gjithçka këtu i detyrohet individit, prandaj, jeta, si e tillë, nuk është tragjike, vetëm jeta individuale e njeriut është e kalueshme dhe tragjike.

Proza lirike, zakonisht shkruhet ne Ich-Form, në vetën e parë, e kjo është në të parë karakteristike e prozave të shkurtra...Në një atmosferë tonën kësodore, proza lirike ka gufuar herë-herë nga dora e disa autorëve tanë, por kurorë e një orientimi të tillë në prozë është romani i Teki Dërvishit, Pirgu i lartë."

Teki Dërvishi është i lidhur ngushtë me teatrin dhe këtë mund ta identifikosh në çdo tekst të tij. Çdo pamje që na jep duket se procesin e krijimit e kalon në syrin e autorit nëpërmjet një inskenimi imagjinar në skenë teatri. Gjithçka përshkruhet në detajet e nevojshme për të paraqitur tablo skenike. Loja është me sa më pak aktorë të mundshëm. Monologë të gjata dhe dialogë të shkurtra e krejt në dyshe dhe shumë pak nga rrëfimi si histori. Kjo ndryshon më shumë te romani i fundit, Palimpsest Dush Kusarit, aty tash kalohet te një diskurs tjetër, ai i dëshmisë dhe rrëfimi merr tjetër konotacion duke iu përgjigjur zhanrit të romanit dokumentar.

Ashtu siç thamë edhe në fillim, loja e Teki Dërvishit është brilant në ndërthurjen e njohjeve të tij letrare në tekst. Ai aplikon çdo gjë nga njohja e tij, që nuk është e vogël duke bërë kështu një gërshetim të jashtëzakonshëm strukturash të cilat vazhdimisht japin në rrafshin stilistik dhe estetik.



Në shiritin e kohës

PËR KOÇO KOSTËN DHE TË TJERË...

Dukej se regjimi kishte vendosur të merrej seriozisht me të. Pak kohë më pas, për shkak të veprës së tij "Ata të dy dhe të tjerë", në mos gaboj, Koços i hiqet e drejta e botimit

Dashnor KOKONOZI

Dëgjoj të flitet pak për shkrimtarin Koço Kosta. Kujtoj shpesh se botimet e tij dikur krijonin atë që sot quhet "buzz", një diskutim që shkonte gojë më gojë e vesh më vesh dhe që atëherë nuk është se i pëlqente shumë regjimit.

Mbase kishte edhe plane për ta dërguar në kasaphanë.

Se më kujtohet, që pasi folëm gjatë nën zë e shpesh duke qeshur për një vepër të tijën, që përshkruante furnizimin me specia dhe erën e tyre që shpërndaheshin nëpër qytet, në Radio erdhi një ish redaktor i Radios që tashmë punonte në Komitetin Qendror a në një Institut marksizmi.

Shkruante edhe vetë libra, por kujdesej të sillte hera herës "lajme" nga lart. Atë ditë, pa e pyetur kush, nisi të tregojë se shoqja Nexhmije ka folur disa herë për letërsinë pa cilësi të Koço Kostës. Për ata lart Koço qe dikush që shkruante për gjëra që nuk kishin vend në letërsinë e vërtetë. Në fund na u "lut" qe kjo të mbetej midis nesh.

Po atë ditë, nja dy orë më pas, kolegu e shefi i Redaksisë së Kulturës, Alfred Kanini, disi i turbulluar më thirri për një kafe dhe më tha se kishte përshtypjen se Koçon e prisnin ditë të këqija.

Pyetjes sime përse mendonte ashtu, iu përgjigj duke më treguar se pak më parë, kur po bisedonte me nja dy kolegë te

Klubi i Lidhjes, mes tyre qe afruar po i njëjti person që paradite kishte qenë në Radio dhe u kishte folur për përshtypjet jo të mira që qe kishin "atje lart" për Koço Kostën. Në fund edhe atyre u qe "lutur" që ajo çka u tha të mbetej aty midis tyre.

Dukej se regjimi kishte vendosur të merrej seriozisht me të. Pak kohë më pas, për shkak të veprës së tij "Ata të dy dhe të tjerë", në mos gaboj, Koços i hiqet e drejta e botimit.

Ne që ishim në dijeni të fjalëve që ishin përhapur për të (që sot e shoh si shenjë të qartë se kishte një organizim perfekt përgatitjeje opinioni për ata që do ta pësonin), prisnim akoma më keq.

Dukej se çatallet prej gize të

diktaturës ishin hapur mirë për Koço Kostën, por nëse u mjaftuan vetëm me sikterisjen e tij në një fshat të Mallakastrës (gjë që sipas skemës ishte faza e parë e zbritjes në Ferr) kjo ndodhi sepse ngjarjet po përshpejtoheshin në drejtime krejt të tjera dhe regjimit po i ndiheshin krisjet dhe grahmat e fundit.

Ai "buzz" i librit të tij mua më ka mbetur në mendje si një nga të paktat shenja jete e realizmi të letërsisë së asaj kohe.

Kishte të tjerë qe e kishin frazën më të stërholluar e limuar se K. Kosta, por sot unë pyes veten: për cilën Shqipëri shkruanin ata, se atë që del në faqet e librave të tyre kam përshtypjen se nuk e kam parë gjëkund.

Për frymëzimin, procesin krijues, kohën...

E TASHMJA REALE SI PENGESË!

Neviana SHEHI

Ndonjëherë më duket se jetojmë në një kohë pa kohë, ndaj dhe sikur nuk kemi me çfarë ta sfidojmë këtë kohë. Midis momenteve, e momentet janë format më të imta të kohës, ne duhet ta gjejmë një shteg, ku graviteti frymëzues është zero dhe ku liria është absolutet, pra e pa ndikuar nga asnjë forcë.

Dhe kur flasim për kohën, duhet theksuar se e kaluara është një gjendje emocionale dhe lidhet me kujtimet e fëmijërisë, rinisë, me të dashurit që s'jetojnë më. E tashmja është gjendje aktive, gjendje ekzistenciale, kurse ardhmja gjendje që në vete ngërthen shumë të panjohura dhe, mbase edhe frikë.

Është e natyrshme se e gjithë larmia dhe shumëllojshmëria e këtyre frymëzimeve në qendër të tyre kanë lirinë. Nëse do ta zgjeronim kufirin e perceptimeve dhe vizioneve tona, do të shikonim se koncepti i lirisë është dhe mbetet më kryesori. Është pikërisht ai koncept që vë në punë motorin e frymëzimeve tona dhe ju jep atyre më gjallëri dhe peshë logjike.

Akti i frymëzimit padyshim se është një akt hyjnor. Është një gjendje shpirtërore që jo gjithkush ka fatin ta provojë. Sigurisht, krijimi në vetvete është një punë e lodhshme dhe e mundimshme, sepse është një rrugë përplot me dilema, kurthe, pakënaqësi, një



rrugë që ndodh të çon dy tre hapa para dhe pastaj të kthen dhjetë hapa prapa. Nëse autori kërkon ta çlirojë veprën e tij nga kufizimet e kohës, duhet patjetër të dalë mbi të, duke krijuar në imagjinatën e tij heronj dhe modele që do të jenë jo vetëm për një kohë të caktuar, por të gjithkohëshme, siç janë bie fjala, veprat e Homerit, Iliada dhe Odiseu, të shkruar para më shumë se 2700 vjetëve. Ne kemi lirinë absolute që personazhin e veprës ta çojmë në të kaluarën e ta kthejmë në të tashme. Jemi të lirë ta vendosim në një kohë të ardhme, duke krijuar

një ambient, që do të ishte prodhim i fantazisë sonë. Prandaj koha nuk është komponentë që na kufizon, përkundrazi. Në kontekst të kësaj, më duket se si pengesë na paraqitet e tashmja reale që ravijëzohet në përditshmërinë tonë.

Në proces kam një libër me tregime poetike, sepse krahas poezisë që moti më intrigon edhe tregimi. Jam diku nga fundi i sistemit të ashtuquajtur bruto material, i cili muajve në vijim, do t'i nënshtrohet një përpunimi më të thukët, për t'ia dhënë dorën e fundit. Deri në këtë proces vetes i kam dhënë

një liri të plotë për sistemin e materialit, kurse tani kjo liri merr trajtë tjetër, sepse kërkon më shumë kohë, e cila, jam e vetëdijshme, se do të përcillet edhe me momente ankthi. Prandaj, koha e finalizimit kërkon një qetësi shpirtërore maksimale, e cila armikun më të madh do ta ketë dinamikën e kohës, dinamikë kjo që përshkohet me shumë trysni.

Dhe shtrohet pyetja: si te arrihet deri te ajo qetësi shpirtërore që të jesh ti dhe vetëm ti, vetë, dhe jo vet e dyzeta, siç themi shpesh. Pra, pengesat krijuese janë të pashmangshme, ndaj dhe përpjekjet bëhen në shumë drejtime, për të arritur deri te finalizimi i projektit. Frymëzimi, liria dhe koha janë tri shtylla, pa të cilat vështirë se do të arrihej realizimi i një veprë letrare. Ndonjëherë kemi frymëzim, por s'kemi kohë, ndonjëherë kemi kohë, por nuk jemi të lirë, ndonjëherë e kemi lirinë, por na mungon frymëzimi. Prandaj, përpjekja për të arritur që këto shtylla të shkrihen në një në shpirtin e shkrimtarit ndonjëherë është e dhimbshme, ndonjëherë kërkon sakrificë dhe në të shumtën e rasteve thjeshtë dorëzohesh dhe pret një moment më të volitshëm për ta kapur trenin që, megjithatë, nuk është i fundit. Në kontekst të kësaj do ta përmend një dyvargësh të Azem Shkrelit, i cili mbase i vë pikën kësaj çështje:

Unë po ia mësoj mendimit tim
një dhimbje të re...

Probleme gjuhësore

SHQIP, O SHQIP(Ë)TAR SHQIPËRIE!

Ledi Shamku SHKRELI

Ka qenë dikur një skeç i Estradës së Fierit me të cilin vijoj e qesh. Lipe Shtogut i kishin vjedhur lopën. Dhe të gjithë ia linin fajin atij: Pse s'e ruajte lopën, si e lidhe, ku ishte, pse s'e pederisa më në fund shpërtheu Lipja: Amani 're shokë amani 're! Opo qysh ere, po hajduti që e vodhi 're, s'ka faj fare ai?!

Ky skeç m'u kujtua ndërkohë që gishti i Policisë Gjuhësore po tregonte mediat dhe portalet fajtoje që po na merrkan në qafë Shqipën, se paskëshin shkruar "Shqipëtar" me ë, e jo Shqiptar siç e ka drejtshkrimi.

Të dashur Policë, në lëmsht-rregullat tuaja keni thënë e ngulmoni të thoni si më poshtë:

Shqip (pa ë) POR Shqipëri (me ë).

Shqiptoj e Shqiptar (pa ë) POR Shqipëroj (me ë). Ndërkohë që SHQIPË nuk ka gjëkund e kjo ë-ja del se kur takohet p-ja me r-në thoni ju, nuk është njëlloj si kur takohet p-ja me t-në, e rruku-rruku e rruku-rruku, e ç'u hyn në xhep Shqipëtarëve si takohen tingujt e shqipëtar në Shqipë a në Shqipërimi?! Mos kemi vallë tremilion gjuhëtarë?! Lipe Shtogu do ju thoshte: Amani bre shokë policë amani bre! Po ju 're, fare s'kini faj ju me kësi xanaxash re?!

Se i bie që Shqiptarët, kur shqipërojnë në shqip apo kur

shqiptojnë emrin Shqipëri, i bie pra që ata (ne të gjithë) ta mbajmë mend me raste teketek se kur ju e doni "ë"-në e kur nuk e doni.

Mendje është e varfra, edhe roit, se e keni mbushur dëngas drejtshkrimin me kësi rastesh kujtese teketek! Dhe e dini ç'bëjnë folësit e çdo gjuhe në kësi rastesh, të dashur ndëshkues? Shtiejnë në punë atë që quhet Analogji, pra vendosin një rregull të njëjtë për të gjitha rastet e kështu mbajnë mend veç rregullën edhe kaq! Pra o të gjitha me "ë", o të gjitha pa "ë". Edhe nuk e gabojnë më!

Futini një të rilexuar Saussure-it, "Kurs i Gjuhësisë së Përgjithshme", se ai i varfri ka një kapitull të tërë për Analogjinë. Për ju e ka shkruar, paçka se njëri nga ju, shokë policë, tha se Saussure tanimë ishte i tejkaluar. Po qysh ere e tejkaluat kur nuk e kaluat?!

Le që ç'ju kërkoj dhe unë juve, jo Saussure jo dëngër-mëngër!

"Stalini dhe çështje të gjuhësisë" si e ndan këtë punën me Shqiptar e Shqipëri? Si si? Thotë që "shkelësit po na marrin më qafë perandorinë"?

Kuptova. E di Stalini që ju keni kërkuar ligj kundër Normëshkelësve shqipëtarë? Po nuk e diti, thuajani këtë gjë Stalinit, se do gëzohet!

POETI SAID NGA TETOVA DHE POEZITË E TIJ

Poeti, shairi Said bën pjesë në poetët shqiptarë nga Tetova që kanë shkruar poezitë e tyre në turqishten e vjetër. Nuk kemi shumë njohuri në lidhje me jetën e tij dhe nuk përmendet në librat biografike të poetëve të periudhës osmane



Metin IZETI

Informatat në lidhje me periudhën kur ka jetuar i marrim nga disa vargje kronogramike të shkruara nga ana e tij me rastin e vdekjes së udhërrëfyesit të tij shpirtëror Baba Abbasit. Pasi Baba Abbasi, përndryshe shejh i teqesë Harabati Baba në Tetovë, kishte vdekur në vitin 1218/1803-4, na jep të kuptojmë se Saidi në këtë kohë ishte poet i pjekur, ngase ishte në gjendje të shkruajë vargje kronogramike për shejhin e vet. Si rrjedhojë konstatojmë se poeti Said ka mundësi të ketë lindur në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe ka jetuar edhe në gjysmën e parë të shekullit të XIX.

Saidi krahas turqishtes së vjetër e ka njohur edhe arabishten dhe persishten dhe kjo tregon se ai ka ndjekur mësimet e rregullta dhe ka qenë i arsimuar. Poezitë e ka të shkruara në ujdj me kallëpet dhe metrikën e poezisë klasike osmane. Nga poezitë e tij që i ka shkruar për Gostivarin, Tetovën, fshatin Saraqinë, fshatin Pallçishtë, kuptojmë se ai ka lindur në rrethinën e Tetovës dhe më pas është vendosur në qytet. Vargjet kronogramike të fundit të poetit na e tregojnë datën 1232/1816-17 që do të thotë se ai në këto vite ka qenë ende në jetë dhe ka shkruar një dyvargësh për ta lavdëruar Rexhep Pashain, pasi ai e kishte ndërtuar rrugën me kalldrëm për në fshatin Saraqinë.

Saidi ka qenë në marrëdhënie shumë të mira me Rexhep Pashain dhe familjen e tij. Në disa poezi të tij, ai thur lavde për personalitetin dhe veprimtarinë e Rexhep Pashait.

*Ata janë mbrojtës të qytetit, në çdo gjuhë lavdërohen
Mbrojtja e tyre është e pranishme në çdo cep, nuk fshihen*

*Nëse begatitë e tyre për çdo ditë në qytet shihen
Nga Krijuesi zemërgjerë kanë ardhur, le të dihen*

*Çdo punë e kanë të bukur, me të shtypurin shoqërohen
Zoti ju ndihmoftë në këtë botë, dhe në botën tjetër të shpërblehen.*

Saidi është një personalitet sufi. Ai është një sufi që i përmbahet tarikatis bektashiane. Kjo mund të shihet pothuajse në të gjitha poezitë e tij. Poezia e parë në përmbledhjen e poezive të Saidit, që është në dorëshkrim, i kushtohet lavdërimit të bijve të Profetit. Një poezi e tij i kushtohet edhe Ibrahim Dedeut me të cilin ishte takuar dhe i kishte dëgjuar bisedat e tij. Më pas është një ilahi sufike dhe një poemë historike për shejhun e tij, Baba Abbasin. Gjithashtu ka edhe një poezi në strofa katërvargëshe ku flet për shehlerët që ai i ka takuar. Poezia në formën e një gazeli me titullin "semai/qiellore" i ka karakteristikat e një poezie që këshillon kërkimin e një udhërrëfyesi apo përkushtimin ndaj shejhit. Dy poezitë e fundit janë poezi me mësimë didaktike sufike.

Saidi ka profil të një poeti që është në mes të dy stileve të poezisë, poezisë së divanit dhe poezisë popullore, që në thelb bazohen në të njëjtën traditë. Gjuha e tij është turqishtja e Rumelisë/Balkanit dhe ka qenë e kuptueshme për nënqiellin ku ka jetuar dhe vepruar.

Shumica e poezive të tij janë shkruar me frymë dhe qëllim sufik. Pothuajse të gjitha poezitë lavdëruese janë të rezervuara për emra që kanë jetuar në kohën dhe vendin e poetit. Por gjithnjë duke e pasur parasysh përmasën shpirtërore dhe sufike të tyre. Edhe në vargjet që ia kushton Rexhep Pashait, theksi është i vendo-

sur në atë se ai është sufi dhe njeri shpirtëror.

Siç u përmend edhe më lartë, një poezi e tij i është kushtuar bijve të Profetit, 12 imamëve:

*Imami parë është ai shërbyes i Burimit të xhenetit dhe mbret i miqësisë
U lavdërua si trim i pashaq dhe dhuratë e qenësisë*

*Drita e syve të mi, Husejni, mbreti i dashur dhe plotë bukur
Ditë e natë mbi Jezidin qoftë i lëshuar mallkimi.*

Edhe në poezitë tjera të tij mbretëron koncepti sufik, madje disa kanë edhe karakteristika këshillëdhënëse:

*Fjalën e myrshidit (udhërrëfyesit) dëgjoje, zemrën pastroje
Puthe gotën e dashurisë hyjnore, bën përpjekje, përpjekje.*

Saidi ka shkruar edhe disa poezi në të cilat i përshkruan dhe lavdëron Tetovën, Gostivarin, fshatin Pallçishtë dhe Saraqinë. Në fillim, pasqyrohet imazhi natyror i qytetit apo fshatit, më pas përshkruhet përmasa historike dhe kulturore, ndërsa në pjesën e fundit përmenden varret e personaliteteve që kanë dalë në pah me identitetin e tyre sufik dhe kontributin e tyre për këto vise.

Ja çka thotë, Saidi, për Tetovën:

*Një shpirt, dhuratë hyjnore, është Tetova
Sinqeritet e pastërti është për të dashurin, Tetova
Burim i dritës së shariatit, vatër e sekretit të tarikatis
Thesar perlash të hakikatit (realitetit) është për gnostikët.*

*Nga përjetësia bartet lavdia për ty, me plotni,
Të zbukuroi, I Bukuri absolut, çdo anë me shumë stoli
Lumenjtë që rrjedhin japin plot gjallëri
Tetovë, e meriton, nëse them se s'ke rival në qenësi.*

Në vargjet në vazhdim Saidi flet për shehlerët sufi, të cilët kanë qenë të pranishëm apo të varrosur në qytetin e Tetovës. Këta vargje të Saidit janë të rëndësishme edhe për identifikimin e jetës fetare dhe kulturore në qytetin e Tetovës.

*Nga njëra anë të mbron Sersem Ali Baba
Në kodër lart mbi ty qëndron Kojun Baba
Në anën tjetër çdo dëshirë ta plotëson Jarar Baba
Ndihma të vjen në katër anë, Tetovë, e dashura.*

Bëhet fjalë për tre teqe bektashiane të cilat janë në qytetin e Tetovës. Sersem Ali Baba është emri i dytë i Teqesë Harabati Baba në Tetovë, ndërsa teqeja e Kojun Babës është në fshatin Shipkovicë në malësi të Tetovës, por për fat të keq në periudhën komuniste është uzurpuar nga pushteti dhe është përdorur si qendër ushtarake, ndërsa tash është e braktisur dhe lënë pas dore. Kurse, teqeja e Jarar ose Javer Babës ka qenë në dalje të Tetovës në afërsi të fshatit Poroj. Kjo teqe është uzurpuar që në periudhën e Mbretërisë jugosllave dhe i është dhënë në pronësi një serbi të quajtur Stole dhe deri vonë vendi ku ka qenë teqeja është thirrur me emrin "Teqeja e Stoles".

Poeti Saidi në këtë poezi për Tetovën na jep edhe informata tjera, të cilat për fat të keq, nuk kemi mundësi t'i vërtetojmë në bazë të dhënave që i kemi. Ai thotë që teqenë e parë në Tetovë e kanë hapur Halveti-Sinanitë dhe më pas një shejh i kadirive i quajtur Shejh Minuri.

*Në fillim teqenë e kanë hapur dervishët sinani
Pozitat e tyre janë të dashura dhe plot miqësi
Me mëshirë i afrohen çdo njeriu në afërsi
Sekretet të gjalla i ka Tetova në përgjithësi.*

*Çarshia e Epërme ishte në fillim e banuar
Minur Babai teqe ka themeluar
Djali i tij Mahmudi si dhe Abbasi ishin të dalluar
Tetovë ti je vend pjellor dervish për të edukuar.*

Sipas Saidit në afërsi të Sahat Kullës, që do të thotë te xhamia e Sahatit teqe ka patur Shejh Aliu dhe afër tij ka qenë edhe Shejh Mensuri. Ndërsa në Çarshinë e Poshtme ka qenë një shejh me emrin Sulejman si dhe nipi i tij Mehmedi. Ata kanë qenë të vendosur në afërsi të Eski Xhamisë në qendër të Tetovës.

Në vargjet e fundit Saidi thotë se Tetova është një qytet përplot me miq të Zotit dhe ka një atmosferë të bujshme shpirtërore dhe se shumë vështirë është të përmenden të gjithë personalitetet që kanë jetuar dhe vepruar në këtë qytet.

FATI I INDIVIDIT NGA FERRI NË FERR

(Nehas Sopaj: "Vallja e vdekjes së verdhë", trilogji, Kumanovë, 2020)

Shkëlzen HALIMI

Nehas Sopaj, një individualitet i veçantë në letërsinë shqiptare, e cila letërsi, për shkak të mentalitetit provincial, fatkeqësisht akoma nuk po trajtohet ashtu siç e meriton dhe ashtu siç objektivisht duhet të jetë, kohë më parë na erdhi edhe me një vepër që po kështu është e veçantë dhe si e tillë edhe do të duhet të trajtohet. Në fakt, çdo vepër e shkrimtarit Nehas Sopaj është një provokim jo vetëm për lexuesin, por edhe për kritikën, e cila akoma nuk e ka thënë fjalën e duhur për krijimtarinë e Sopajt, i cili në letrat shqipe është prezent më shumë se katër dekada. Krijimtaria e Sopajt është komplekse, është jashtë shablloneve, me të cilat kemi bashkëjetuar e ndoshta akoma bashkëjetojmë. Por, ai ka krijuar standardin e tij dhe prandaj themi se është i veçantë në letrat tona. Mbase, këtë ai e dëshmoi edhe në qasjen e tij studimore të veprave të dy kolosëve të letërsisë shqiptare, Beqir Musliut dhe Teki Dërvishit, dy vepra këto që plotësu-an një boshllëk të madh të studimit të letërsisë shqiptare.

Vepra më e re e autorit tonë, "Vallja e vdekjes së verdhë", është padyshim një nga veprat me të realizuara të tij që, gjithsesi, duhet të zgjojë kureshtjen e lexuesve tanë, sepse është e shkruar me një gjuhë të pasur dhe me një game të madhe të figurave stilistike. "Vallja e vdekjes së verdhë", një titull shumë simbolik, një titull që vetvetiu flet shumë, brenda vetes ngërthen tre romane: "Bukla", "Kronika e zezë nga koha e kuqe" dhe "Rruga e gaforres", romane të cilat kanë një ind që i lidh dhe i bën si një tërësi. Pra, bëhet fjalë për një trilogji, me një përmbajtje, do të thoshim, jo vetëm magjike, por edhe lirike, pse jo dhe tragjike. Çdo lexues që do të ketë sado pak kulturë leximi, do ta ndjejë magjinë e rrëfimit, e cila ka një rrjedhë herë - herë edhe të pazakontë në kuptimin e mirë të fjalës, gjë që vetvetiu imponon edhe pyetje: nga e merr autori fuqinë e shprehjes aq bukur të gjërave që ta ndriçojnë shpirtin? Është kredoja e Nehasit se më mirë se me shkrim nuk mund të shprehet bota e brendshme e individit, aq më tepër e një bote që është përplot me drithërima shpirtërore.

Padyshim se boshti i kësaj trilogjia është fati i narratorit, i cili narracionin e tij e shtrin në një hark të gjatë kohor, duke filluar nga fëmijëria, bota e secilës fëmijëri është një kujtim i pashlyeshëm dhe që nuk na ndahet deri në frymën e fundit. Në zanafillë të kësaj bote është edhe e vërteta, kurse kjo botë e shkrimtarit tonë ka një përmbajtje shumë të pasur me rrëfime herë

herë fantastike, por që në fakt janë reale, siç vijëzohen në romanin "Bukla", ku vjen në shprehje fuqia magjike e rrëfimit, ku del në pah bota shpirtërore e autorit, por edhe ndjenjat dhe emocionet e tij për realitetin, që natyrisht dallon nga realiteti i përditshëm.


Romani "Bukla" është një nga realizimet më brilante të Nehas Sopajt. Një vepër që mund të lexohet edhe si tregim, edhe si roman, edhe si poezi, edhe si monodramë, por edhe si dramë. Mund ta lexoni një herë, dy herë, tri herë dhe më shumë herë. Por, sa herë që ta lexoni do të ndjeni se po lexoni gjëra të reja që ju lënë një shije të këndshme shpirtërore, pavarësisht nëse bëhet fjalë edhe për ndonjë çast të dhimbshëm, kur ngrihet dilema mes shpirtërores dhe materiale, e cila në rastin konkret, fatmirësisht nuk bëhet dilemë hamletiane, por një e vërtetë e përhershme e shkrimtarit, se pasuria më e madhe e secilit duhet të jetë pasuria shpirtërore.

Fati i individit në këtë libër do të shohim se kalon nga ferri në ferr. "Kronika e zezë nga koha e kuqe", është një ngjarje e rrëfyer tri herë. Në fakt, fati individual lirshëm mund të identifikohet edhe me fatin kolektiv, siç është ajo nga koha e kuqe, pra komuniste, kur kapitulli i historisë shqiptare pas ngjarjeve të vitit 1981 (demonstratat e studentëve në Prishtinë), u bë thjeshtë një kronikë e zezë. Është kjo një metaforë brilante e autorit, i cili këtë kronikë të zezë do ta përjetojë edhe në lëkurën e vet, duke qenë me vite e vite në shënjestër të syrit të kohës së kuqe.

Nuk është vështirë të kuptohet se çfarë përjetoi narratori në atë golgotë të kuqe, e cila në një mënyrë do të bëhet lajt-motiv kolektiv, por para se gjithash një kujdes permanent ndaj atij që e dinte dhe i shërbente të vërtetës, përmes shkrimit si një ilaç shpirtëror që bënte zgjimin nga kllapia e kohës së kuqe.

Dhe ferri shpirtëror do të vazhdojë te "Rruga e gaforres", në të cilën do të paraqitet dëshmia e kohës së kuqe, ankthi i narratorit dhe, natyrisht, ngritjet dhe rëniet shpirtërore, duke u përmblytur me një poezi të mrekullueshëm, "Afro gjysmë shekulli", një poezi që tregon se pavarësisht se rruga e gaforres bëhet mbrapsht, koha lëviz përpara, duke lënë shumë vragë, nga të cilët duhet të nxjerrim ndonjë dobi, për të mos thënë ndonjë mësim.

"Vallja e vdekjes së verdhë" është një vepër që gjithsesi do t'i rezistojë kohës, pavarësisht se librit shqip ia kemi imponuar krizën e leximit. Është një vepër që do të duhet jo vetëm të lexohet dhe rilexohet.



Është një vepër, të cilës studimi kritik nuk guxon t'i ikë, sepse anashkalimi i kësaj veprë, kritikën dhe studimin e letërsisë thjeshtë e bën më të mëngët, edhe atë për shkak të veçantisë së shkrimtarit Nehas Sopaj, por edhe veçantisë së veprës së tij, që, në aspektin e cilësisë, dukshëm dallon nga veprat

në sasi të madhe, shumica e të cilave, fatkeqësisht, shërbejnë vetëm për konstatimin e inflacionit në veprimtarinë e pakontrolluar botuese.

Ndërkaq, ky libër lexuesin e vet do të gjejë edhe ndër brezat që vijnë, sepse përmbajtja e saj është e gjithë-kohëshme.

NGA KËNGA E NDRYDHUR DERI TE KËNGA E RINGJALLUR

(Faruk Buzhala: "Njëqind poezi", Shtëpia botuese OM, 2023)

Prend BUZHALA

Të njëqind poezitë e tij Faruk Buzhala i thur në trajtën pesëvargëshit (pentastikut). Në pesëvargësh hyjnë të gjitha format poetike që përbëjnë nga pesë vargje brenda një njësie strofike, siç janë kvinta, tanka, cinquain, quintilla, soneti 99 i Shekspirit dhe vargjet limerick. Te këta pesëvargësh ka një normë personale të vendosur: secila njësi strofike përbën një poezi më vete, kurse gjatësia e vargjeve nuk përfill ndonjë rregull a normë të caktuar metrike, siç i ka në disa nga format e tilla të pentastikut. Bie fjala, sado që një tanka ka strukturë të rrokjeve 5-7-5-7-7 (ose 31 rrokje në një varg të pandërprerë), dhe sado që këto poezi i ngjajnë tanka-s, ato ndryshojnë. Ndonjë përlligje e krijimit personal, siç është vargu i dytë shpesh i përbërë nga një fjalë, krijon një poetikë të mëvetësishme.

1. Psikolirika dhe drama e mbylljes

Edhe vetë titulli përbën një shënjes poetik më vete. Nëse numri njëqind, është shënjes i një rrumbullakësimi, herën tjetër simbol i një numri engjëllor, ai është edhe numër i ndërliqshëm i fatit, i hapjes ndaj një perspektive të re. Këto "anë të jashtme", gjithsesi që shënojnë fushat e interesimit artistik, e megjithatë, nuk përbëjnë thelbin e vlerës së një poezie. Zëri poetik i këtij krijuesi buron nga bota e brendshme e krijimeve të këtij vëllimi. Nëpër vargje lexojmë kycjen dhe mbylljen. A është kjo mbyllja a përfundimi i një marrëdhënieje, referencë për një humbje, refuzim për të mos e pranuar një realitet që përfundon ende pa u shfaqur vlerat e brendshme? Madje, kycja e këngës shfaqet si botë e shurdhër dhe, së andejm, nga ajo mbylltësi a ndrydhje, e krijon zërin e vet lirik:

*Kënga ime e kyçur në arkë
shurdhmemecë dhe syshkoqur
me gërvishtje krijon melodinë
në errësirën ndrydhur nga ajri
frymon me dëshirën për lirinë.*

Nëse kjo këngë vjen nga zërat e mbytur së brendshmi, si zë vuarjesh e ankthesh, atëherë shpërthimi i kornizës me krijimin e melodisë vjen po nga ai realitet i tillë, për të mos i pranuar rrethanat e tilla, me gjakimet për lirinë. Krijimi i kësaj melodie të jetës dhe dashurisë është zë shprehe që shpërthen këtë kornizë. Pas mbylljes (pentastiku i aprë), shfaqet gropa, po ashtu sinonim i mbylljes, ngufatjes, shfaqet „Kafaz i mbyllur në zemër zogu”. Dhe diçka e ka ngufatur ndjesinë e folësit lirik: "Një gropë e pistë u zhyt në mua/ në fyt më mban shtrenguar". A ka aty braktisje, therje zemrash, humbje, vuajtje? Dhe si del përtej këtyre casteve subjekti lirik? Ky është absurdi i një situatë, mbase jo vetëm personale. Është një të folur për vetveten, aq sa dhe për mallin, është kujtesë për dashurinë, për miqtë etj.; aty vrujtojnë protestë dhe ironi e kontrolluar, imazhe shqetësimesh për kohën, vetminë, për psiko-situatë:

*I bëj masazh mendimeve
cigarja mes gishtërinjve
tretet në hirin e vet
e unë
në tym metamorfozohem.*

Ka aq e aq shumë përpëlittje të brendshme, përplasjes dramatike, ka aq shumë imazhe e përfytyrime sfilitesë, që e shndërrojnë qenien e folësit lirik herë në groteskë, herë në torzo, herë shfaqet qenieplotë, herë qenie e ndrydhur me zemër të copëzuar, herë loz në një realitet-mozaik... herë shfaqet nëpër vargje një realitet krejtësisht i tjetërsuar teknologjike, si makro-e-mikrokozmos:

*E futa shtëpinë në USB
dhe dola.
E tani...
ku ta fus USB- në
ta nxjerr shtëpinë nga aty!*

E herë si botë ku sundon një shurdhëri karshi urtisë. Dhe këndimi i tillë shfaqet si një psikolirikë, me perigje e apogje raportesh, saqë protagonistët lirikë duken të hallakatur... dhe, së andejm, me fat të përcaktuar dashurie „për njëri-tjetrin”. Së këndejm, ndodh një vetërobërim i pëlqyeshëm, si peng fati e emocionit:

*Nuk je ti
Por është dashuria
Ajo që ia mban rrezet peng
Diellit të perënduar
Në zemrën time të robëruar.*

Po aty vrujtojnë edhe thëniet gjithë pulsime kontrastuese, shpesh nxjerr kokë një rrëfim gjithë provokime për ta vënë në pah njohjen e tjetrit/tjetres me vetënjohjen.

2. Romantika e shprishur e jetës

Lexojmë përpjekjen për ta rijetuar atë që është humbur njëherë, një këmbëngulje dhe përkushtim që gjithçka të kapet brenda një strukture me pak vargje, dhe mu aty për ta shqiptuar zërin e tij lirik. Lirikës si gjurmë malli. Një përshkrim referues i patologjisë sonë sociale. Një rindërtim i kuptimit të fjalëve, për t'i dhënë kuptim realitetit dhe jetës vetë. Dhe gjithnjë i rikthehet emocionit burimor, dashurisë:

*Një grimcë të shpirtit
E nduka
Dhe e futa në mallin tim
Ta dërgoj me porosi
Kur ta hapësh t'më gjeshe mua aty.
Me prirjen që ta ndërtojë në mënyrë origjinale performancën e tij poetike dhe ligjërimore,
Faruku përafrohet me ata poetë të letërsisë së sotme që duan ta shpërfaqin një fenomenologji (postmoderne) me tjetër frymë:
Lëre hidhërimin të rrjedhë
Rrjedhës së vet
Kupën e çastit me zemërim mos e pi
Merr frymë merr*



Derisa sheh se furtuna kaloi.

Romantika e jetës është shprishur. Koha shfaqet në ndërliqësitë e ngatërrimet e saj fanepsëse. Sado që vjen një tjetër mot, gjurmët mbasin me detajet teje të gjalla, si hije a përhitje:

*Kuvendoj me hijen time
nuk pajtohem!
zihemi, pickohemi e rrihemi
e në fund...*

ç'mallëmi në përfaqim.

Tashmë poeti ka dhënë përgjigjen e tij pasi i ka gjetur ato nëpër kërkime. Dhe përgjigjet poetike i drejtohen ndjenjës më fisnike:

*Hape portën tënde
dashuri
më lër të hy brenda
të prehem
në prehrin tënd.*

Kurse poeti gjendet në kërkim të qartësisë, në kërkim të përgjigjeve, përtej një gjendjeje të turbullt: për një fazë të re jete, ashtu siç sugjeron numri engjëllor- njëqind. Nga ana tjetër, vargjet ngërthejnë edhe virytin e tyre të brendshëm: shpresën dhe vullnetin e durimit për të jetuar lirshëm në atë pluhur kohe (metaforë e poetit). Është sfida e kapërcimit të gjendjes së tillë: për të dalë nga psikolirika.

3. Dalja nga psikolirika

A është e mundshme dalja? Ndodh që lirika të jetë një rrugatë herë me vetveten, herë me botësh, herë me miqtë e herë me dashurinë. Në lexim përgjigjet i kërkim nëpërmes vargjeve të poetit. Ato ndriçojnë, ato thurin dramën e vetvetes, ato edhe çlirojnë. Si zjarri që ndriçon dhe ngroh, sado që vargjet vijnë me thellësinë e përsiatjvet të ftohta. Por aty ka zjarr: folësi lirik është ai që kapërcen nëpër ravat e ngushta të ekzistimit, dhe ndriçimi vjen së andejm, nga vlerat që ka arti, si hapësirë terapeutike për ta njohur vetveten dhe botën: lexuesi identifikohet me anët simbolike që t'i ofron këndvështrimi artistik. E po, ka aty psiko-lirikë, për faktin se poeti, duke ligjëruar në veten e parë, ai e shpreh botën e tij të brendshme, kurse këndimi lirik i rruhd hapësirat e ndrydhura të ankthit, ndrydhjes, zbrazëtisë. E pra, kërkohet edhe mirëqenia psikologjike.

Regjistrat poetikë nënvizojnë përvojat e kundërta personale të përgjithshme, me figura nga jeta e përditshme deri te temat jetike, siç janë dashuria, ekzistenca, fati dhe malli. Modeli poetik i Faruk Buzhalës është i mëvetësishëm: një bashkërendim situatash reale me ato të habitshme, një skenë e çuditshme shndërrohet në lirikë përsiatjesh. Në vend të flakës së emocioneve, ai fut në mënyrë diskrete shprehje e përmbajtje ironike, situata skeptike, gjithnjë me vargje të shkurta, me ekonomizimin e thënies e me ligjërim të kultivuar artistik.

Poezitë i alternojnë gjendjet e ndryshme, nëpër të 100 lirikat, si njëqind situata të tilla gjendjesh të brendshme: që nga terratisjet e brendshme e deri të spërndritjet e ndjesisë së dashurisë, që nga lirikat e dendësisë së thënies e deri te përfaqjet metafizike.

*Shpirti përpëlitet
në follenë e vet
mendimeve u zvarritet
fshehtas një brengë;
Ka ngërçe në bark!*


Autori fal nga dhuntitë e shpirtit të tij. Sado e rëndë të jetë jeta me labirintet e saj psiko-so-ciale, ai gjithnjë thotë se ka rrugëdalje. Dhe nuk është e rastit përse librin e përmbyll me poezinë e njëqindtë kushtuar muzës Talia, bijë e Zeusit, muzë e komedisë, poezisë bukolike, teatrit, perëndeshë e muzikës, vallëzimit dhe këngës.

*Ah... Talia
më e bukura e të bukurave
se si më ngjalle
zemrën dhe...
e bëre të rrahë vetëm për ty.*

Talia merr attribute të çlirimut, ngjalljes, së bukurës. E kjo ndodh pasi poeti u sprovua nëpërmes Këngës së Ndrydhur që në fund vjen si Këngë e Ringjallur.

LEXIMI INTERTEKSTUAL I KADARESË

Simbolet mitike të Kadaresë janë vetëdije kolektive që fillojnë me vetvetëdijen. Njeriu nuk është i plotë derisa qenia dhe vetëdija janë në disproporcion



Afrim REXHEPI

Definicioni klasik për mitin: miti është rrëfim i thjeshtë / shprehje për krijimin e botës, njerëzve, perëndive, për realitet natyror dhe social. Shkaku: esenca e gjenezës së botës dhe fillet e saj, rrëfim për krijimin. Njeriu antik parashtror skemën mitike: shenjzim i kaosit - transformim në kozmos, përmes pyetjeve pse dhe si. Modusi ekzistencial - autori, me tendencë të përgjigjet në pyetjet e parashtrara, për bazë ka mitin antik, ka formën fabulative - parafiguracionin që e transformon në konfiguracion. Në esencë, miti është shkrim që reflekton në letërsinë e sotme, modulacion i refleksionit - kuptimit. Për Shelingun, mitologjia është parafiguracioni bazë i konfiguracionit. "Është materie e përhershme, nga e cila rikrijohen çuditërisht, forma të ndryshme". (Sheling; 81) Interaksioni mit - letërsi, shënohet miti parafiguracioni i temave ekspresive letrare, receptorë modelativ - konfiguracioni i figurave mitike. Kategoria kaos, do të thotë ikje nga koha aktuale, ikje e autorit nga faktika në fikcion. Implikacion: formëzim i mitit të formëzuar. Parafiguracion: figurat mitike Prometheu / Kali i Trojës - konfiguracion: figurat letrare Prometheu /

Përbindëshi.

Teksti artistik gjuhësor është shenjë, është tërësi kuptimore. Rolan Barti përcakton interaksionin e mitit sot: sistem semiotik i shkallës së dytë, metagjuhë e gjuhës. "Shenja në gjuhë, shenjuesi në mit, kthimi i mitit nga kuptimi në formë". (Barthes; 15) Përcaktim analogjik: shenjuesi është projektion metonimik në raport me tërësinë, mikrokozmos në makrokozmos. Teksti shenjë krijon raporte:

-të ngjashme, në analogji me referentët që i shënjon dhe -të kontaktit pjesë - tërësi.

Raportet janë konstituencë e asociacioneve të ngjashme midis botës së tekstit dhe referentit. Raporti shenjë - referent është raport logjik pjesë - tërësi. Bota e tekstit (skema narrative hetero - homodiegeza, koordinatat kohore - hapësinore), nuk është projektion sinekdodik - pjesë e tërësisë, është projektion metonimik - tërësi e tërësisë, përkatësi e tërësisë, strukturë jokoherente e botës, strukturë imanente e ekzistencës, projektion tekstual që konkretizohet në interpretim. "Fakti që letërsia kupton vullnet për komunikim të vazhduar, detyron ta projektojme atë si mesazh deri në ndonjë "qëllim të pacaktuar". (Durand; 27) Në metagjuhën e kritikës,

metonimia shndërrohet në metaforë. Kuptueshmëria e metaforës diskurzive varet nga kontinuiteti metonimik. Tekst - metafora është tendencë estetike, përmes fizikës (fjalës) prek metafizikën (idenë, emocionin) / është operacion që zhvillohet në mendim e jo në fjalë. Tekstet Përbindëshi / Prometheu, i përcaktojmë tekst - metaforë përmes principit ngjashmëri - analogji. Rinjohim dialektikën e krizës, ekzistencën kaotike të njeriut të kohës sonë, një rinjohje nga një anë tjetër e kontaktit. Fenomeni rrëfim, është fenomen i transformimit të rrëfimit me implikacione semantike. Transformimet semantike realizohen përmes: analogjisë (metafora, personifikimi), kontakti / kontiguiteti (metonimia, paranomaza), pjesa e tërësisë (sinekdoka), e kundërta (ironia, satira, antiteza), kundërthënia (oksimoroni, paradoksi, groteskut) etj.

Teksti - shenjë është polisemik. P. sh. Prometheu / Përbindëshi, përveç që janë tekst - metaforë, janë edhe tekst - alegori. Distinkcion: në planin makrostruktural të tekstit, alegoria nuk mund të identifikohet me metaforën, të trajtohet metaforë e zgjatur. Dykuptimësia e alegorisë, përveç në principin analogji - ngjashmëri, bartet edhe në principin aluzion. Teksti letrar është shenjë paradigmatiche: tekst - metaforë, tekst - alegori. Vlera eksplicite semantike e alegorisë është dhënë në tekst, vlera implicite semantike e alegorisë jepet nga potenciali semantik i tekstit. Në strukturën e tekstit, alegoria sjell kohën si konstituencë bazë, zbulon kohën përmes riaktualizimit si akt konstitutiv i të kuptuarit. Mbi kokë të Prometheut fluturojnë aeroplanët (Ismail Kadare, Totali është aluzion i Kalit të Trojës. "Kalin që bëra unë, ishte me këmbë në mit me kokë në bashkëkohësi". (Kadare; 1993) Rrëfimi intertekstual i romanit Përbindëshi është parabolë e kohës mitike dhe kohës aktuale: grabitja e Lenës nga Genti / grabitja e Helenës (bukurisë) nga Paridi; kali i drurit / furgoni i mbeturinave etj., janë alegori e sistemit totalitar.

Teksti - alegori, është projektion edhe i procesit të simbolizimit. Distinkcion: simboli për nga struktura është sinekdokë, nuk është të folur i dykuptimshëm. Simboli

është sintezë subjekt - objekt, është transferim i attributeve të subjektit në objekt. Alegoria është shenjë gjuhësore që e vë në konstruksion funksional realitetin fizik. Simboli është konjunksion imazh - lëndë, alegoria është disjunksion imazh - lëndë. Teksti - shenjë posedon alegorinë dhe simbolin, dy entitete ekspresive të ndara. "Miti i Kadaresë...është tip i mitit letrar që ka lënë faktin për ta transformuar në simbol". (Çapriqi; 55) Bërthama e mitit është arketipi apo gjuha e simbolit: implikon tendencën, figurat simbol - Prometheu / Kali i Trojës, janë arketipa / nënvetëdije kolektive - tradhti e qëndresë. Simbolet mitike të Kadaresë janë vetëdije kolektive që fillojnë me vetvetëdijen. Njeriu nuk është i plotë derisa qenia dhe vetëdija janë në disproporcion. Figura mitike e transformuar në model të rikrijimit - palimpsest, ndryshon qenien e lexuesit intertekstual, është iniciacion - kalim nga një gjendje në një gjendje tjetër të vetëdijes.

Miti për Kadarenë nuk është materie statike, por dinamike, është materie intertekstuale, është materie lëvizëse, ndryshon në kohë nga lexuesi intertekstual - interpreti përmes procedimit demitizim, është kod i dekoduar për realitetin fizik. Kadare përdor procedimin demitizim, sepse e ka të qartë që qenia dhe historia janë objekte njohëse, ndryshojnë. Historia komparative e religjionit dhe filozofisë, definojnë mitin strukturë verbale që konservon qenien, kuptimin (Shlegeli dhe Niçe, Eljade dhe Krape); shprehja apo të shfaqurit e qenies në një rrëfim, mit, definohet përkthim i interpretit të qenies. Definicioni klasik për hermeneutikën, shënon interpretimin dhe sqaron kuptimin e qenies. Për Hajdegerin, fenomenologjia e ekzistencës (Da - sein) është hermeneutikë denotative e fjalës, përmes së cilës realizohet interpretimi. Parashtrorët pyetja që njëkohësisht është mitike (supstanciale) dhe hermeneutike: pyetja e krijimit, dekodimi i kodit esencial të qenies, botës. Demitizimi si akt intertekstual i leximit, i mundëson Kadaresë të interpretojë dhe të shpjegojë të vërtetën e fshehtësisë së kohës historike, duke kapur intensitetin e përjetimit të parë, analogji e intensitetit mitik.

DARRELL STANDING, NJË PERSONAZH I SHUMËFISHTË

Romani "Endacaku i yjeve" i Xhek Londonit ka një titull mjaft simbolik. Ai shënjon ëndrrën për jetë, për të bukurën, mbart dramën që kupton njeriu kur këtë të bukur nuk e kuptoi në kohë dhe e ndjen më së shumti kur ndodhet në bashkekzistencë me të shëmtuarën, qelitë e burgut dhe shëmtinë e instinktit të tij vrasës. Pra, afron një katrsis të habitshëm dhe kuptimplotë

Qazim SHEHU

Leximi i një vepre të Xhek Londonit edhe sot është një kënaqësi e veçantë. Shkrimtarin e madh jemi mësuar ta përfytyrojmë përmes tregimeve të tij të famshme për Alaskën, nga romani "Martin Iden" dhe vepra të tjera, ku ai pasqyron temën e vështirë të kërkuesve të arit, natyrën, botën e qenëve, slitat në dëborë, natyrën e ashpër, luftën për ekzistencë dhe vullnetin e njerëzve të fortë. Nuk është se ky përfytyrim m'u trondit kur lexova veprën "Endacaku i yjeve", por ai m'u zgjerua dhe më solli një anë tjetër të procedurës krijuese të këtij shkrimtari gjenial. Ato tipare të veprave të tij më të mira, si furia e jetës, personazhe të fortë dhe këmbëngulës, janë edhe këtu, por e veçanta e këtij libri që më mbërtheu, është trilli, imagjinata dhe kërkimet e vazhdueshme në psikologjinë e personazhit Darrell Standing, personazh i cili në kërkimet strukturore dhe thyerjet kompozicionale shumëfishohet te shumë njerëz, që fotografohet në pamje e fytyra të shumëfishta dhe rikthehet për të na krijuar një portret të vetëm.

Por kush është ky? Darrell Standing ka kryer një vrasje dhe kështu gjendet në burg. Në burg përmes një lejeve me pakot e duhanit, kurdiset një lojë sikur janë futur pako me dinamit. Të gjithë autoritetet alarmohen dhe kurdisësi i lojës është spiun i tyre. Darrell Standing duhet të tregojë dinamitin, edhe pse nuk di asgjë. Ai vuan torturat në këmbishën e forcës (një këmbishë e gomuar me efekte shtrënguese që të nxjerr filluskën e fundit të ajrit nga mushkëria) dhe në fund shkon drejt litarit. Dhe drejt litarit ai shkon me një ëndërr për jetën. Nuk është thjesht një ton optimist mbylljeje, por një vijimësi e qartë e gjithë ideve të romanit, që çon detyrimisht dhe natyrshëm deri këtu.

Darrell Standing përfaqëson në vetvete një hero realist, por edhe një hero absurd, me talljet që u bënë autoriteteve të burgut, pamjeve të shëmtuara të jetës, vdekjes dhe dashurisë së pakuptueshme për marrëzinë, ai shkon pa u drojtur në litar, nuk e ka frikë vdekjen, edhe pse është i dashuruar me jetën. Pakuptueshmëria e asaj që ndodh, ka ndodhur dhe mund të ndodhë, është një frymë e përhershme e përshkrimit narrativ të Xhek Londonit në këtë vepër që lexohet me një frymë dhe të mbërthen nga fillimi në fund. Këtij personazhi mund t'i hedhësh vështrime të shumta dhe, në çdo vështrim, ai të shfaqet në mënyra të ndryshme, për të kënaqur këshërëritë e tua estetike. Mund ta marrësh edhe si Mersonë e Kamysë, edhe pse nuk i ngjan plotësisht, mund ta marrësh edhe si një dashnor të rrëmbyer, edhe si një aventurier që nuk i ikën rrezikut, por edhe si një të përgjyruar pas Jezu Krishtit, dhe si një njeri që kërkon të bindë Pilatin. Darrell Standing është personazhi kaleidoskop dhe i shumëfishuar, nuk është i zhvilluar në një linjë karakteri, as i formësuar plotësisht, sepse ai është vetë njeriu i provuar në rrethana ekzistenciale të vështira dhe kundërtënëse. Megjithatë, ai ka një fytyrë të veçantë, të kujton personazhin e fortë të Londonit, personazhin që, me një vullnet të palëkundur, i drejtohet rrezikut, tallet dhe e përqesh vdekjen, edhe pse e di që realiteti i saj është i pashmangshëm.

Kjo mënyrë e të konceptuarit dhe të shtjelluarit është veçori e talentit të Londonit, por formësohet më së shumti në këtë roman. Ajo vjen nga njohja e madhe e jetës prej Londonit (kujtojmë këtu punët e shumta që bëri, nga më të rëndomtave, udhëtimet e tij me anije në det, gazetar në luftën e Koresë, leximet e shumta dhe kulturimin e jashtëzakonshëm të tij). Njohja e mjedisit është në vazhden e shkrimtarëve realistë; burgu me të gjitha elementët e tij, përshkrimi i qelive, trokitjet në mur midis të burgosurve, me një kod të kuptueshëm komu-



nikimi midis tyre, loja me mizat si të vetmet gjallesa që vinin nga jashtë, barbarinë e drejtorit të burgut dhe sadistëve që hurin e mbajnë në dorë, mësimi dhe përshtatja me vuajtjen dhe torturën, si një sfidë morale ndaj dhunës, të gjitha këto janë përshkruar aq bukur, sa sigurojnë një gjuhë filmike, të rrjedhshme, ngjethëse dhe trishtuese e të mbërthejnë në ankth leximor, duke të afruar aq lehtë mundësinë e përfytyrimit, sikur je aty.

Por, ky është edhe një roman psikologjik e poetik. Sa më e dukshme bëhet mungesa e jetës, aq më e madhe vjen dashuria për të, aq më thellë dhe bindshëm futet personazhi në vetvete dhe reflekton gjithçka që nga fëmijëria, aq më shumë rritet ëndrra dhe shpalolet ajo gjer në më të mundshmen e shfaqjes së saj. Aq më tepër kërkohet diçka që nuk vjen kurrë, si në dramën e Becketit. Poezia e shpirtit, ëndrra dhe thellësia e saj vjen e konfondohet me çastet e hidhura të një realiteti gri-zi, aspekti psikologjik, kalon shpesh në tone të holla të infiltuara filozofike, nxirren filozofime dhe sentenca që vijnë si përvoja të jetës aktive të personazhit. Në aspektin strukturor autori e ndan jetën e personazhit në dy kohë: në burg dhe para se të futet aty, jeta në burg është një shurdhëri totale me ato mjetet e zakonshme të torturës, durimit dhe të heshtjes, ndërsa jeta që vjen në trajtën e kujtesës është mjaft e përthyer dhe sjell episode nga më të papriturat e plot këshërëri, që sillen me një stil të zhdërvjellët e në prizme kontrastesh. Koha e personazhit nuk fillon në burg, por koha e burgut mundëson të na shfaqë gjithë kohën e tij, nga

fëmijëria deri kur shkon në litar, ndërsa meditimet e shumta dhe përshkrimet filozofike dhe kuptimi i thelbit njerëzor në zbërthimin e tij të plotë ngrihen deri në përgjithësim mbi fatin e njeriut në tërësi.

Pasuria e madhe e lëndës jetësore që mbush biografinë e personazhit ndihmon dhe i jep krah fantazisë së shkrimtarit për të hulumtuar artistikisht në thelbin e njeriut, në padrejtësitë e kësaj bote, te lufta, dhuna, te dashuria dhe urrejtja, te aventura dhe qetësia, te lartësia e së ariturës dhe rënia, pastaj te hakmarrja që vjen si rezultat i dhunës dhe padrejtësisë. Aspektet e moskuptimit të së drejtës dhe i tolerancës për jetën vijnë edhe si rezultat i keqkuptimit por edhe i egos njerëzore, edhe si ngutje për të dalë nga rreziku, edhe si mishërimi idealit të ulët, gjë të cilat e bëjnë këtë roman të rrallë, mjaft domethënës dhe konkret, por edhe si një platformë apo pistë e së mundshmes, nga ku mund të ngrihen plot ide drejt qiellit të ëndrrave. Në aspektin e rrefimit nuk kemi linearitet, përkundrazi vepra shënon bindshëm një strukturë të mirorganizuar, pa i ikur boshtit tematik dhe ideor, duke qëndruar mirë në hullitë e mesazheve me rrenjë boshtore në një realitet mjedisor, por edhe në një realitet psikologjik.

Digresionet e shumta, pjesët në dukje të palidhura, por që organizohen përmes idesë qendrore dhe afrojnë pamje të njëjta, përmes paralelizmave ideore, jo vetëm sigurojnë tërheqjen e vetëdijshme dhe intuitive leximore, por ato përforcojnë bindshëm idetë dhe mesazhin qendror të romanit. Nganjëherë të duket se nuk është Darrell Standing që

rrëfen, por koha, ose një copëz e shkëputur nga historia, që nga antikiteti e deri sot, e cila duket sikur ka ndodhur dhe ruhet në shpirtin njerëzor. Në këtë zallamahi të kuptueshme, Darrell shtron pyetjen: "Kush do të jem nesër?", ndërsa romani mbyllet me frazat domethënëse: "Kush do të jem kur të jetoi përsëri? Cilat gra do të më dashurojnë vallë? Sa kureshtar jam!..."

Autori me këto fjali shkon gjer te thelbi i jetës, Darrell është një si-vëllai i tij në çdo vend e çdo kohë, ai këto fjalë i thotë para se të vdesë, e beson këtë dhe nuk do t'ia dijë, por e di se fytyra e tij është fytyra e një tjetri, se prapë do të këtë vrasës, të burgosur. Ky përgjithësim që autori i bën personazhit të tij, e ngre atë në një nivel universal brenda kontekstit ideor të romanit, por pa lënë mangët ngjyrimet e kohës, prandaj kjo vepër lexohet edhe sot dhe ruan freskinë e saj të ideve dhe të poetikës së hollë të shpirtit njerëzor në çdo kohë, ashtu siç rëndom ndodh edhe me vepra të tjera të autorëve të mëdhenj.

Romani "Endacaku i yjeve" i Xhek Londonit ka një titull mjaft simbolik. Ai shënjon ëndrrën për jetë, për të bukurën, mbart dramën që kupton njeriu kur këtë të bukur nuk e kuptoi në kohë dhe e ndjen më së shumti kur ndodhet në bashkekzistencë me të shëmtuarën, qelitë e burgut dhe shëmtinë e instinktit të tij vrasës. Pra, afron një katrsis të habitshëm dhe kuptimplotë.

Personazhi e pranon fajin, por nuk bindet që ky faj të bëhet një pengesë për dashurinë për jetën dhe këtu është drama e tij e lahtarshme psikologjike, dramë që shtjellohet duke i dhënë krah kujtesës dhe fantazisë, ku tablotë dhe sequencat e bukurisë dhe njomësisë së jetës shpalosen me shpejtësi marramendëse.

Zbulimi i kësaj drame nuk vjen gradualisht, por që në fillim, por ajo thellohet prej gasteve dhe episodeve të pafundme përmes kujtesës, ndërsa romani mbetet një trallisje e vazhdueshme e kësaj kujtese, që shënjohet në dy kohë e personazhit, për të arritur te koha e tretë e asgjësë.

Stili i Londonit është mjaft i lakmueshëm, i thjeshtë, i bukur, fluid, i mbushur me sentenca dhe me mësim mbi jetën. Ky autor ka sjellë edhe në vepra të tjera realitetin e ashpër amerikan të atyre viteve, duke e ndërthurur atë bukur me fatin e njeriut vullnet-hekurt dhe të bindur në aftësitë e tij. Narracioni, përgjithësisht në vetën e parë, nuk mëton në prirje të stërgjatura të frazës për të rënë në tendencë të sforcuara filozofike, përkundrazi ai është një rrefim që përmes ndodhjeve interesante të jetës, zbulon filozofinë e saj. Ky është arti i madh, kjo është veçori e talentit të Londonit, i cili di të vërë në drejtpeshojë jetën me filozofinë dhe jo filozofinë si abstraksion i ftohtë, ku duket të gjejmë kuptime të fshehta që mbyllin njëra-tjetrën si në çark.

Personazhe të gjalla, të mbushur me jetë e drama të mëdha, aq të fuqishme, sa duket sikur janë afër nesh, na rrëfejnë për jetën dhe të fshehtat e shpirtit njerëzor, për të keqen dhe mizoritë e saj, por më së shumti sesi duhet ta vlerësojmë jetën edhe në ndonjë çast kur verbata e harrojme bukurinë e saj.

Përshkrime të shumta, plot detaje dhe pamje interesante, ku çdo personazh ka fytyrën e tij të gdhendur e bën këtë roman të këndshëm, por njëherit dëshmon për vëzhgimin e hollë psikologjik, aftësinë përshkruese dhe tipizimin e fuqishëm në një vertikale individualizuese të thellë. Përshkrimet mbushen me një informacion jetësor dhe të besueshëm, informacion që mban gjallë dinamizmin e rrefimit dhe nuk mundesh, nëse e fillon, ta lëshosh këtë vepër brilante nga dora, që është sjellë me mjeshtëri në shqip nga përkthyesi Asllan Saraçi.

PERGAMENË E HIRTË

Në pergamenën e hirtë prej drite
Pikturon karafila të zi
Dhe përfytyrimin e fytyrës së saj të bukur

Atë shëmbëlltyrë që kurrë s'e pa
Vetëm zërin ia dëgjo

Atë zë të djegur
Në të qeshurën e saj
Me një jehonë deri te veshi i zotit

I zotit që harroi t'i bëjë
Bebëzat me dritë

Piktorit
Që pikturon në pergamenën e hirtë prej drite
Karafila të zi

PERTEJ TERRIT*

Me qepalla
lëvizin hënën yjet
natën e vdekur
përtej territ të zi

drita çelet në sy

me përtesë
dielli lind i kuq
si syri i zotit të përgjumur

*Dita e shtatë unë dhe Blendi me Kovid 19,
si duket do e mundim?!

ORA

Kohën e ngujoj në orë
në orën time me gurë të djegur
pres akrepat e fjetur
t'i bien ziles
të më zgjojë
para se bryma të bie
mbi lule
mbi ato lule të egra
që kurrë nuk çelin
Ajo pip e re
duart m'i zgjat
qe dy mijë vjet

BALONAT*

Ato balona të shumta në qiell
Si bulëzat e ylbërta
Janë prej meje
Tërë natën i kam fryrë
Me frymën time të sëmurë

Mezi i kam qitur nga dritarja e ngushtë
Me kujdes që të mos pëlcasin
E ta prishin ëndrrën tënde të bukur
Me mua përdore diku anë një lumi

Mbylle dritaren
lëshoji perdet e errëta
S'dua t'i shoh duke rënë
Të përdredhur në ajër
Si pëllumbat që u çelet vetëm një krah

I lëshoi fryma ime e ligë
Po bien
S' dëgjohet më muzikë
U prish festa
A s'i dëgjon sesi qajnë fëmijët

*Nga një bisedë e dëgjuar për afërsisht kështu, në mes të
një vocërraku dhe një nëne në një dhomë spitali në Gisen!

KA KOHE E DASHUR

Ka kohë e dashur
Ngjitemi në bregun e blertë
Shikojmë përmallshëm perëndimin e diellit
Bredhim bulevardëve me erë
Nën drunjtë që u bien gjethet
Dëgjojmë kambanat e vdekjes
Muzgu na zë tek të heshturit
Pranë një varri pa emër
Vendosim lule të gra
E bëhemi terr

ONIRIKE

Sa u ktheva nga të vdekurit
Gjeta vdekur të gjallë

Kumti vetëm
Një pergamenë e bardhë

SPARAGMOS*

Ku i kam sytë e blertë
gjuha e buzët e afshëta
ku janë

krahët e përmallshëm
duart e gishti me unazë
ku mbetën

këmbët
e thembrat e shpejta mbi rërë
m'i pa kush

bisedojnë në mes vete
një kafkë e thyer e një asht i bardhë
që i lëpin një qen nate
mbi hurin e zi

*Sparagmos do të thotë copëtimi i pjesëve të trupit flijues!
o të thotë copëtimi i pjesëve të trupit flijues!..

PROFESORI

Profesorit që kishte ligjëruar
në amfiteatrot më të famshme botërore
një ditë ia grisën pasaportën

tani e dyzet vjet
ulur në një gur të bardhë buzëdetit
flet vetmevete
e zë peshq
me një shkop kallami
me tojë të këputur

Sarandë, gusht '21

NANËS

Nënës ia hoqëm
vathët verdhë prej hëne
unazën e hollë si fije bari
edhe telat e flokëve prej kane

u bë frymë e lehtë
për fluturim në qiell

s' kemi për ta parë kurrë më
veç si kujtim
në çaste mërzie
e engjell
në parajsë prej ëndrre

POETI AKADEMIK

është përfshirë në
antologji të panumërta.

ai ka marrë bursa
dhe grante.

ai është i njohur si aktivist
dhe socialist.

ai aktualisht është duke botuar
një poemë goxha të gjatë
që do t'i ketë disa vëllime,
plot me referenca misterioze dhe të errëta.

të paktën një herë në muaj
citon Eskilin
dhe Pindarin.

ka botuar disa vëllime të bisedave dhe
eseve.

e luan për merak
këtë lojë.

gjithmonë është i sigurt të shtrëngojë
dorën e duhur.
ai po ashtu
kurrë s'ka pasur thua të thyer
dhe qeni i tij kurrë nuk ka vjellë në qilim.

faturat i paguan gjithmonë

s'ka bërë vaki
ta ketë humbur
ndonjë vakt buke.

çorapet gjithmonë i ka çift,
flokët gjithmonë të krehura
kurrë nuk ka bërë ndonjë gomarllëk
para familjes apo miqve.

edhe
poezia e tij
e dëshmon një gjë të tillë.

në të nuk ka shpirt,
nuk ka koqe.

është krejt boshe...

sall muhabet.

kur të vdesë ai,
akademikë të tjerë
do të diskutojnë për jetën e tij
dhe do t'ia analizojnë librat.

njerëzit do ta harrojnë.

kurse akademikë të tjerë
do t'ia zënë vendin.

dhe të tjerët
së shpejti do t'ua vendin zënë atyre.

kam frikë
se gjithmonë do të ketë
akademikë,
të buzëqeshur, me besim në vete
dhe të sigurt.

dhe kjo
është vetëm edhe
një arsye më shumë
se përse ju
absolutisht keni nevojë
për

dikë

si
unë.

POETËT E FACEBOOK-ut

duket se i kalojnë ditët
duke uruar njëri-tjetrin
për gjenialitetin e tyre
për bloget e tyre
për faqet e tyre të internetit
për fotot e tyre
për kafen e tyre
për drekën e tyre.

poetët e facebook-ut
kënaqen
duke e quajtur njëri-tjetrin poet.

krejt të obsesionuar
me ato pëlqime të kota,

mprihen
kot
se dikujt me të vërtetë
ia ndien.

KËTA POETË TË VJETËR HALABAKA

që shkruajnë poshtë e lart
"më pëlqeu poezia jote, a të
pëlqeu e imja?"
tingëllojnë
si dy nxënës
të klasës së tretë
që luajnë
kashelashë
pas shkollë
mbrapa kishës

RECETË PËR TË SHPËTUAR NJË JETË

Besa KALAJA

Erdhi me një recetë në duar, nuk e kuptova për çfarë ishte. Këto ilaçe duhet t'i blesh më tha dhe recetën e lëshoi në një komodinë afër pa denjuar të ma japë në dorë. Nuk e di a u neverit nga unë a çfarë ndodhi, pasi kisha disa ditë që nuk isha larë e këtë më së shumti e tregonin flokët që më ishin bërë shumë të yndyrshëm. Çfarë janë këto, çfarë të blej? - u mata ta pyes, por nuk pata guxim, pasi fytyra e saj ishte bërë e kuqërremtë nga inati.

E mora recetën, kurrë s'kisha qenë në spital dhe nuk merrja vesh fare nga shëndetësia, apo ndoshta kisha qenë nja dy herë dhe atë vetëm për pak minuta sa për t'i parë disa të afërm. Kështu është jeta, të dërgon drejt e në spital.

E mora recetën dhe po vrapoja shkallëve për t'i marrë sa më shpejt, por kisha një dyshim të thellë. Poqse se i gjej a duhet t'ia jep apo jo? Nëse nuk do t'i gjej, a do të ishte ky shpëtimi i tij dhe i imi njëkohësisht? Këtë nuk mund ta dija në atë çast.

Po më vështirësohej frymëmarrja dhe temperatura po shënonte gati 34 gradë celsius. Kalova rrugën me ngut, në anën tjetër ishte barnatorja. I lëshova recetën në dorë farmacistes, ajo po e shikonte atë me shumë kujdes.

Ngriti kokën dhe më pa në fytyrë. Prej çfarë sëmundjeje vuani? - më pyeti.

-Nuk kam sëmundje specifike i thashë por herë pas here harroj se kush jam. Qesha dhe i tregova që barnat nuk ishin për mua, por për një të afërm që prej disa ditësh ishte i shtrirë në spital.

-Mirë, më tha, po a nuk të kanë treguar në spital se barna të tilla nuk ka jo vetëm tek ne po askund në botë?


E pashë në sy dhe i thashë se saktësisht para 5 minutave e 34 sekondave, pra në orën 10 e 15 minuta mjekja e repartit erdhi drejt meje dhe ma lëshoi këtë recetë në duar.

-Zonjë dukeni e lodhur, ma bëri tërë kujdes, mund të ketë pasur ndonjë keqkuptim, mos vuani nga pagjumësia ose ndonjë gjë tjetër të kësaj natyre. E kuptova që nuk donte të më pyeste drejtpërdrejt se mos vuaja nga ndonjë sëmundje mendore, po sytë nuk m'i largonte asnjëherë nga flokët, të cilat veç sa nuk po më pikonin yndyrë.

-Jo, i thashë pak e nervozuar unë, nuk vuaj prej asnjë gjëje, kam ardhur këtu me këtë recetë, e cila para pak çastesh mu la mbi komodinë nga një mjekje me flokë të verdhë. Këto duhet t'i blesh më tha, dhe unë u nisa me vrap për këtu, sepse nga sytë e saj e kuptova që duhej të ngutesha sa nuk ishte bërë vonë. Të lutem, sa rri e humb kohën me supozimet se prej çfarë sëmundje mund të vuaj unë, me ndihmo ta shpëtoj një njëri që po pret ndihmë nga unë.

Më tha se duhej të kujdesesha për veten dhe për t'më siguruar që barna të tilla nuk ekzistojnë, hyri në një kthinë dhe prej atje doli më një burrë.

-Unë jam farmacisti kryesor - më



tha - dhe më zgjati dorën.

Ia dhashë jo për gjë tjetër, por kishte kohë që askush nuk më kishte ofruar dorën. Ma shtrëngoi miqësisht dhe më ftoi të ulesha. E pyeti vajzën nëse më kishte lutur për kafe, por ajo i tha që nuk e kishte bërë një gjë të tillë, pasi unë po ngutesha. Vetëm në atë çast e pashë që kisha shtrënguar shumë recetën a thua se prej saj varej jeta e një njeriu dhe atë jetë e kisha unë në dorë.

-Doni kafe ma bëri ai, si për të dashur të më largojë nga mendimet dhe frika që kisha në ato çaste.

-Jo i thashë, por një gotë ujë do ta pija me kënaqësi se bën shumë vapë. Fillova t'i tregoj se vapa e kësaj vere më kishte prishur shumë plane. U bë se i vinte keq dhe më tërhoqi vëmendjen që pasi nuk kisha shumë kohë mund të flisnim për barnat që më duheshin. Ia afrova recetën. Nga djersa kishte filluar të fshihej, ai mori syzet se ashtu tha se ishte e vështirë të kuptohej e thirri në ndihmë edhe vajzën për t'i treguar se cila ishte shkronja e mesit që ishte fshirë. Ajo u mendua një copë herë dhe i tha se shkronja ishte a. Kjo e vuri më shumë në mendime farmacistin i cili e thirri dikë në telefon.

Fiku telefonin dhe po endej sa andej- këndeje. Ne derë hynë dy policë

të cilët iu afruan kryefarmacistit. Ai po bënte me dorë nga unë, po unë nuk e prisha terezinë, e pyeta farmacisten se a i kishin gjetur barnat dhe mos e gjithë kjo vonesë ishte tregues se ato ishin gjetur? Ajo më tërhoqi vërejtjen, ma përkujtoi se ato nuk mund të gjendeshin askund në botë. U mundova t'i them edhe njëherë që recetën ma dha mjekja, po nuk arrita ta përfundoj fjalinë, pasi njëri prej policëve po vinte drejt meje. Ia shtriva dorën. Për një kohë dora më mbeti në ajër.

-Zonjë, më tha ai, sapo u njoftova se barnat që ju po kërkoni nuk ekzistojnë, kush ju tha se mund t'i merrni ato?

I thashë që ishte doktoresha e cila nuk më do mua, por nga unë kërkon që të shpëtoj një jetë njeriu. Më pyeti nëse do kisha mirësinë që së bashku të shkonim ta takonim mjekun. I thashë që veç njëherë e kisha takuar dhe nuk e di çfarë fytyre kishte. U mundova ta ndihmoj me faktin se e dija që flokët i kishte të verdhë.

-Nuk ka barna të tilla, po i thoshte farmacisti.

-Nuk je ti autoriteti për të treguar a ka apo nuk ka barna të tilla, i tha polici. Ia përkujtoi se në dorë kishte një recetë të nënshkruar dhe me vulë. Ne kemi një provë në dorë i tha

kolegut të tij, ndërsa mua më tha se mund të shkoja me ta në stacion të policisë. Ju tregova se nuk mund ta bëja një gjë të tillë, pasi kisha një jetë njeriu për të shpëtuar. Njëri prej tyre më pyeti se kush ishte personi të cilin duhet të shpëtoja, në cilin spital ishte, cili ishte numri i dhomës, reparti, nga cila sëmundje vuante dhe plot pyetje të tjera.

I pyeta nëse isha nën hetime, pasi pyetje të tilla po më frikësonin.

-Nuk jeni nën hetime zonjë, më tha polici, veç bëhej fjalë për diçka për të cilën ata duhet të gjenin përgjigje. Pastaj, tha ai ju sapo më thatë që keni në dorë jetën e një njeriu.

Ia thashë emrin e spitalit, numrin 24 të dhomës, katin e tretë, emrin e pacientit, që ishte 52 vjeç, dhe i tregova që mbi komodinë kishte fotografinë e të birit.

Panë njëri- tjetrin në sy dhe të dy më morën përdore dhe më thanë që së bashku duhet të shkonim në spital.

-Ne mund të shkojmë, ju thashë por tani nuk është që po më kujtohet se në cilin spital është. E di që numrin e dhomës e ka 23, kati i katërt dhe që është 60 vjeç.

Polici më tha që pak më parë i kisha dhënë të dhëna të tjera për të sëmurin.

Shkuan në kthinë dhe po bisedonin diçka me farmacistin. Ai nuk u thoshte gjë vetëm ngrinte krahët. Vajza u tha se po të qëndroja edhe pak aty do t'më binte të fikët.

-A e shihni u tha atyre si e bardha e syve i është bërë e verdhë?

Kjo e frikësoi farmacistin tjetër, i cili në vend që të kthehej nga unë e t'më shikonte sytë i tha asaj që kjo nuk është normale dhe se duhej t'më shihte edhe njëherë se mos më ishin skuqur sytë.

-Jo, i tha ajo, sytë i ka të verdhë.

Farmacisti i luti dy policët që t'më largojnë nga aty, po ata thanë që në kushte të tilla duhet ta thërrasin ambulancën.

Ju lutem, ju thashë, nëse veç pak e keni parasysh gjendjen e personit më gjeni barnat dhe unë do të iki vetë nga këtu. Sytë e mi nuk tregojnë shenja sëmundjeje, mos u frikësoni, vetëm duhet t'mi gjeni barnat.

Hapa telefonin, zilja po më bënte prej disa sekondash. Unë jam ende këtu, i thashë personit me të cilin po flisja. Po i tregova se ilaçet nuk i kisha gjetur dhe se m'i kishin prerë edhe shpresat që ato mund të gjendeshin ndokund. I thashë që ju kisha bërë edhe presion, po nuk kishte asgjë prej asaj pune. Njëri nga policët po më rrinte te koka. Sapo mbylla telefonin më pyeti se me kë fola. I thashë se ishin nga spitali dhe po më kërkonin ilaçet. Policët iu duk se kjo punë po merrte të mbarën, tani mund të shkonim në spital e të bisedonim me autoritetet atje.

Unë i thashë se ende nuk po më kujtohej se cili spital ishte.

U çova në këmbë, sytë po më rrotulloheshin, i ndjeva kërdhokullat e syve si më bënin naze, sa andej-këtej. Rashë në tokë.

SUSPANSJA

Tek Uliksi i Xhejms Xhojsit, ngjarjet banale dhe të papërfunduara të një dite në Dublinin modern mbivendosen sipër storjes heroike dhe të mbyllur të kthimit të Odiseut nga lufta e Trojës

David LODGE

Në fillim, kur vdekja dukej e pamundur, sepse nuk iu kishte afruar kurrë më parë, Knighti nuk mendonte për të ardhmen, as për ndonjë gjë që lidhej me të kaluarën. Ai vështronte ashpër përpjekjen e pabesë të Natyrës që dëshironte ta vriste dhe përpiqej ta pengonte. Fakti se shkëmbi formonte sipërfaqen e brendshme të segmentit të cilindrit bosh, duke pasur qiellin lart dhe detin poshtë, që kufizonte gjirin në masën e një gjysmërrethi, ai shihte sipërfaqen vertikale lakuar përreth tij. Shikoi poshtë faqes së shkëmbit dhe e kuptoi kërcënimin. Tmerri i vërehej në çdo tipar, madje edhe në zorrë forma e rrezikut ishte rrënuese.

Me një ndërthurje të zakonshme të gjërave, ku bota e pajetë ndërson mendjen e njeriut kur ndalet në çaste pezullie, përballë syve të Knightit ishte ngulur një fosil, që qëndronte në reliev të ulët nga shkëmbi. Ishte krijesë me sy. Sytë, të vdekur e të ngurtësuar, po e shikonin edhe tani. Ishte krustac i hershëm i quajtur Trilobite. Të ndarë mes vete nga miliona vjet, duke se Knight dhe kjo krijesë ishin takuar në vendin e vdekjes së tyre. Ishte e vetmja gjë, brenda fushëpamjes së tij, që kishte qenë e gjallë dhe kishte pasur trup për t'u shpëtuar siç ishte ai tani. (THOMAS HARDY, Një palë sy të kaltër - 1873)

ROMANET JANË NARRATIVA dhe narrativa në çfarëdo mediumi - fjalë, film, film vizatimor - ngjall interesin e audiencës duke ngritur pyetje në mendjet e tyre dhe duke vonuar përgjigjet. Pyetjet përgjithësisht janë dy llojesh dhe kanë të bëjnë me kauzalitetin (p.sh. kush e bëri?) dhe kohëshmërinë (p.sh. çfarë ndodh më pas?), secila e shfaqur në formë të pastër në storjet klasike me detektivë, përkatësisht storjet me aventura. Suspansa është efekt i lidhur sidomos me storjet aventureske dhe me shartimin e storjeve me detektivë dhe storjeve me aventura të njohura si triler. Narrativat e tilla dizajnohen asisoj që ta vënë heroinën ose heroin vazhdimisht në situata ekstreme rreziku dhe, sa i përket përfundimit, ato ngjallin emocione të frikës, dhembshurisë dhe ankthit të lexuesi.

Meqenëse suspansa, në mënyrë të veçantë, është e lidhur me format e popullarizuara të fiksonit, ajo shpesh përbeje ose degradohej nga romancierët e periudhës moderne. Për shembull, tek Uliksi i Xhejms Xhojsit, ngjarjet banale dhe të papërfunduara të një dite në Dublinin modern mbivendosen sipër storjes heroike dhe të mbyllur të kthimit të Odiseut nga lufta e Trojës, duke lënë të nënkuptohet se realiteti është më pak emocional dhe më i papërcaktuar sesa fiksoni tradicional na bën të besojmë. Por, ka pasur shkrimtarë të mëdhenj, veçanërisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë, që me vetëdije huazuan mjetet e suspansës nga fiksonet e popullarizuara dhe i përdoren për qëllime të tyre.

I tillë ishte Thomas Hardy, romani i parë i botuar i të cilit, Shërime dëshpëruese (1871), ishte "roman sensacional" në stilin e Wilkie Collinsit. Vepra e tij e tretë, Një palë sy të kaltër (1873), ishte më lirike dhe psiko-logjike. Ajo mbështetej në miqësinë e Hardit me gruan e tij të parë në mjedisin romantik të Cornwallit verior dhe ishte romani i pëlqyer i mjeshtrit të fikcioneve autobiografike moderne, Marsel Prustit. Por, ajo përmban një skenë klasike të suspansës që, me sa e di, ishte tërësisht e shpikur. Vetë termi rrjedh nga fjala latine që do të thotë "varje" dhe vështirë se ekziston situatë më produktive e suspansës sesa ajo e njeriut që ngjitet me majat e gishtave në sipërfaqen e shkëmbit,

ku është e pamundur të ngjitet sigurt - për pasojë kemi termin e përgjithshëm "cliff-hanger" (varje në shkëmb).

Pothuajse në gjysmë të veprës Një palë sy të kaltër heroina e re dhe kapriçioze, Elfrida, vajza e famullitarit kornish, e merr teleskopin në majë të një shkëmbi të lartë me pamje nga Kanali i Bristolit, për ta parë anijen që e sillte nga India në shtëpi, arkitektin e ri me të cilën ishte fejuar fshehurazi. Ajo është e shoqëruar nga Henry Knight, mik i njerëzës së saj, burrë i pjekur, intelektual, që i kishte propozuar fejesë dhe ndaj të cilit ndien tërheqje të fajshme. Posa ulen në majë të shkëmbit, kapela e Knightit fluturon drejt thepit dhe, kur përpriqet ta kapë, bie dhe nuk është në gjendje më të ngjitet në shpatin e rrëshqitshëm dhe përfundon duke rënë disa qindra metra poshtë. Përpjekja impulsive e Elfridës ta ndihmojë, vetëm i vështirëson gjërat më shumë dhe ndërsa ajo ngjitet prapë në vend të sigurt, aksidentalisht bën që ai të rrëshqasë drejt katastrofës. "Ndërsa rrëshqet ngadalë inç pas inçi... Knight bëri një vërsulje të fundit dëshpëruese në tufën e pakët të bimësisë - në nyjat e zgjatura të barishteve të thara ku shfaqej shkëmbi i zhveshur. Kjo ndali rëniën e tij të mëtejshme. Knight tani vërtet varej nga krahet e tij.. (kursivi im). Elfrida humb nga pamja e Knightit, me gjasë të kërkojë ndihmë, megjithëse ai e dinte se ata gjendeshin milje larg nga çdo frymë njeriu.

Çfarë ndodh më pas? A mbijeton Knighti dhe, nëse po, si? Suspansa mbahet vetëm duke i vonuar përgjigjet e këtyre pyetjeve. Një mënyrë për ta bërë këtë, për dashamirët e kinemasë (efektet e së cilës Hardy i anticipoi shpesh në fiksonet e gjalla vizuale) do të ishte kryqëzimi i ankthit të Knightit me përpjekjet e furishme të heroinës për të gjetur shpëtim. Por Hardy dëshiron ta befasojë Knightin (dhe lexuesin) me reagimin e Elfridës ndaj urgjencës dhe për këtë arsye rrëfirmin e skenës e kufizon vetëm nga këndvështrimi i Knightit. Suspansa zgjatet duke përshkruar në detaje mendimet e tij teksa kapet pas sipërfaqes së shkëmbit. Këto mendime janë ato të një intelektualit viktorian, mbi të cilin zbulimet e fundit në gjeologji dhe historinë natyrore, veçanërisht vepra e Darvinit, kishin lënë përshtypje të thella. Fragmenti ku Knight kupton se po shikon sytë, "të vdekur e të ngurtësuar", të një artropodi të fosilizuar miliona vjet të vjetër, është diçka që vetëm Hardy do ta shkruante. Vepra e tij shquhet për ndërrime të tilla befasuese të këndvështrimit, që shpërfaqin figurën e brishtë njerëzore të sunduar nga Universi, ku dimensionet e mëdha hapësinore dhe kohore, realisht, sapo kishin filluar të kuptoheshin. Dhe personazhet e tij, gabimisht, por kuptueshëm, në këtë çekuilibër nivelesh gjithmonë lexojnë një lloj ligësie kozmike. Nga përballja me sytë e vdekur të fosilit që, në fushëshikimin e tij, zëvendësojnë sytë e kaltër të gjallë e joshës të Elfridës, Knight kupton diçka të re, sa prekëse dhe të tmerrshme, mbi vdekshmërinë e tij.

Skena zgjat disa faqe me të njëjtat mjete: reflektime filozofike mbi gjeologjinë, parahistorinë dhe zemërligësinë evidente të Natyrës (era fshikullonte rrobat e Knightit, shiu ia shponte fytyrën, dielli i kuqërremtë e vështronte "me shikim të dehur") të shënjuara me pyetje që e mbajnë telin e suspansës narrative të nderë: "A do të vdes?... Ai shpreson në shpëtim, por çfarë mund të bëjë vajza? Ai s'guxon të lëvizë asnjë inç. A po ia shtrinte, vërtet, vdekja dorën?" Natyrisht, Elfrida e shpëton. Nuk do ta zbuloj se si ndodh kjo, veçse t'ju them, t'i inkurajoj ata që ende nuk e kanë lexuar këtë libër të mirë, se shpëtimin përfshin heqjen e gjithë rrobave të saj.

(Nga anglishtja: Meliza Krasniqi)



REALITETI DHE MITI, MITI DHE FJALA

Në jetën e përditshme ne e perceptojmë fjalën si hije të realitetit, si reflektim të tij. Më i drejtë do të qe pohimi i kundërt: realiteti është hije e fjalës

Bruno SZULC

Thelbi i realitetit është kuptimi. Atë që nuk ka kuptim e quajmë të pavërtetë. Çdo fragment realiteti jeton falë asaj, që merr pjesë në njëfarë kuptimi universal. Në kozmogonitë e lashta kjo shprehet me sentencën se në fillim ishte fjala. E paemëruara për ne nuk ekziston. Të quash (emërzosh, pagëzosh) diçka, do të thotë ta përfshish këtë diçka në njëfarë kuptimi universal. Fjala e izoluar, mozaike – është produkt i vonë, rezultat i teknikës. Fjala zanafillore ka qenë një vagulli e turbullt providenciale, që rrotullohej qark kuptimit të dritës e shkëlqimit, ka qenë një tërësi e madhërishtme universale. Në kuptimin e rëndomtë të së tashmes, fjala është veçse fragment, rudiment i njëfarë mitologjie të lashtë integrale gjithëvëllimore. Prandaj ekziston në të gjakimi drejt vegjetimit, drejt përmbushjes gjer në plotësinë e kuptimit. Jeta e fjalës ka për natyrë të suspendojë, të tendoset për mijëra lidhje, si trupi i copëtuar i gjarprit të legjendës, copat e të cilit kërkojnë njëra-tjetrën në terr. Organizmi mijëra copash dhe integral i fjalës, rezultoi i shqyer në shprehje të veçanta, tinguj të ligjëratës së zakonshme dhe tashmë në këtë formë të re, e aftësuar për kërkesat praktike, kaloi te ne si organ i të kuptuarit të ndërsjellët. Jeta e fjalës, zhvillimet e saj kanë qenë zhvendosur në binarë të rinj, binarët e jetës praktike, të nënshtruar ndaj ligjësisë të reja. Por sapo kërkesa praktike në njëfarë mënyre i dobëson rregullat e saj të ngurta, sapo që fjala, e çliruar nga ky detyrim me pahir, gjendet ballas tëte-a-tët me veten e vet dhe kthen te ligjësitë e veta, lind një rrjedhë e kundërt, fjala gjakon drejt lidhjeve të lashta, drejt burimit stërgjyshor – eshkun e saj të kthimit te malli për atdheun e parë preletrar ne e quajmë poezi. Poezia është qarku i shkurtër i kuptimit ndërmjet fjalëve, regjenerimi i beftë i riteve primitive. Duke operuar me fjalën e zakonshme, ne harrojmë që këto janë fragmente historish të lashta e të përjetshme, që mu si barbarët ne i ndërtojmë shtëpitë tona prej copëra skulpturash dhe prej buste hyjsh. Ndër idetë tona nuk gjen as edhe një pjesëz të vockël, e cila të mos ketë rrjedhur prej mitologjisë – që të mos ketë qenë e transformuar, deformuar, transfiguruar prej mitologjisë.


Funksioni parësor i Frymës të është të rrëfejë përralla, të krijojë "histori". Forca lëvizëse e shkencës njerëzore është njëmendësia, që në fund të gjurmimit ajo rreh ta

gjejë kuptimin përfundimtar të botës. Dhe ajo e kërkon këtë kuptim në ndërtimet e saj artificiale dhe ndër pyje. Por elementët që shfrytëzon ajo për ndërtime, kanë qenë të shfrytëzuara më përpara, ato rrjedhin prej "historive" të stërharruara dhe të plasaritura. Poezia i rinjeh këto kuptime të bëra fir, i kthen fjalës vendin e saj, i kombinon ato në bashkëpërkim me kuptimet e qëmotshme. Për poetin fjala, si të thuash, ndërmerret, kujton kuptimin e së vërtetës burimore, lulon dhe me një spontanitet të vetvetishëm zhvillohet, sikundër ia diktojnë asaj ligjet e veta, sërishmi përfton tërësinë e vet. Prandaj çdo lloj poezie është mitologjizim, ajo gjakon në rikrijimin e mitit për mitin. Mitologjizimi i botës nuk është kryer. Ky proces veçse qe ndalur nga zhvillimi i shkencës, qe shmangur në një shtrat tjetër diku përbri, ku gjallon, pa qenë i vetëdijshëm për kuptimin e tij të vërtetë. Por edhe shkencë s'është tjetër gjë, pos ngrehinë miti për mitin, sepse miti tashmë është i ndërkallur në elementët më parësorë dhe se përtej sinoreve të mitit ne, sikur të plasim, nuk dalim dot. Poezia mbërrin gjer te kuptimi me anë të parandjesisë profetike, deduktueshëm, në bazë të shkurtimeve të mëdha kurajoze dhe përafrimit. Shkencë gjakon po të njëjtën gjë në mënyrë induktive, metodologjikisht, duke përlogaritur gjithë materialin e studimit. Për nga thelbi i çështjes, dhe njëra, dhe tjetra, synojnë drejt së njëjtës gjë. Shpirti njerëzor është i paepshëm në interpretimin e jetës me ndihmën e miteve, në nxjerrjen e kuptimit të realitetit. Fjala e evidentuar për vetveten gjakon, graviton drejt kuptimit. Kuptimi është po ai element, i cili e tundon njerëzimin në procesin e realitetit. Ai është e dhëna absolute. Atë është e pamundur ta nxjerrësh prej të dhënash të tjera, e pamundur ta shpjegosh se pse diçka paraqitet me kuptim. Procesi i kuptimësimit të botës është i lidhur ngushtë me fjalën. Ligjërimi është organi metafizik i njeriut. Megjithëkëtë, në rrjedhën e kohës, fjala gangullizohet, ngrin, pushon së qeni përcjellëse e kuptimeve të reja. Pra, ajo ia kthen fjalës përcjellshmërinë falë qarqeve (cirkuiteve) të reja, të cilat lindin nga kombinimet e tyre. Simbolet matematike janë thelbi i zgjerimit të fjalëve drejt kufijve të rinj. Piktura (tabloja) është gjithaq reproduksion i fjalës primitive, e cila nuk ishte ende shenjë, por mit, histori, kuptim. Në jetën e përditshme ne e perceptojmë fjalën si hije të realitetit, si reflektim të tij. Më i drejtë do të qe pohimi i kundërt: realiteti është hije e fjalës. Filozofia, në thelb, është filologji e thellë, studim krijues i fjalës.



BARDHOSH GAÇE, NJË UDHËTAR I PALODHUR

Një autor si Bardhosh Gaçe, që në librin e dytë të arkitekturojë individualitetin e tij artistik, nuk është e lehtë, është meritë. Ky tharm, në përmasat e tij, në dukshmërinë dhe padukshmërinë e tij, është i kudoshfaqur



Xhahid BUSHATI

Studiuesit e Letërsisë Shqipe për fëmijë e të rinj, si: Bedri Dedja, Agim Deva, Astrit Bishqemi, Xhevat Sylja, Prend Buzhala, Anton Nikë Berishaj, Faik Shkodra, Ramazan Çadri, poeti Lirim Deda, etj., e në mënyrë të veçantë shkrimtari dhe studiuesi Odhise K. Grillo, - dikush më thellë, dikush më në sipërfaqe, dikush në mënyrë informative, dikush në formë paraqitëse, dikush në kuadër të recensionit, dikush në formë eseje, dikush në vështrim analitik, dikush me përparësi didaktike e pedagogjike, dikush në formë reflektive, dikush me një paraqitje të lirë, etj., i janë qasur herë pas here, në kohë, krijimtarisë poetike të Bardhosh Gaçes, - që siç thotë studiuesi Astrit Bishqemi: "... kemi të bëjmë me një poet që punon shumë me vargjet, që t'i skalisë sa më me mjeshhtëri ato." Studiuesit a kritikët letrarë i janë në dy rrafshë: a) në rrugëtimin poetik të autorit dhe b) në formimin e mëtejshëm i personalitetit krijues i parë në kontributet studimore, folklorike e shkencore (monografike) dhe në marrëdhënie me kohën si shenjë e rëndësishme, kjo e fundit, ekzistence, lavdie dhe jetese historike, mosharrese dhe kujtese.

Bardhosh Gaçe i takon formatit të krijuesve, që iu kushtuan e iu përkushtuan (e që vazhdon) me devocion dhe talent Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Ky përkushtim dhe lëndës letrare që na është ofruar gjer tani, na krijon bindjen e një individualiteti të spikatur në fushën e kësaj letërsie. Poeti Bardhosh Gaçe, që në vëllimin e parë poetik "Dëshira e Anilës", nisi të endë, kërkesën ndaj vetes, fillimisht me vijëzime të lehta për një individualitet artistik. Pas 10 vitesh botimi nga libri i parë, Gaçe vjen me librin e dytë "Vogëlushët e Tërbaçit". Vërtet kemi të bëjmë me një hark kohor prej një dekade, por në

krijimtarinë e autorit ky është libri i dytë; por tani ndodhemi përpara një dukurie që ia vlen të theksohet. (Kjo dukuri nuk është aq e shpeshtë në Letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj). Poeti, si nga ana e problematikës, personazhet që lëvizin e jetojnë në poezi, ngjarjet që fiksohen, atmosfera, mjetet e shprehjes, ligjërimi, koha dhe përtej koha, etj., sikur i ka vënë vetes detyrë të përcaktojë qenësishëm individualitetin e tij poetik. Ka disa pyetje që autori nëpërmjet vargjeve të tij u jep përgjigje, si këto: "Besoj më njihni se nga vij. E kuptoni trevën time, historinë dhe lavdinë e saj. Besoj e kam pasqyruar realisht atmosferën që ka jetuar realisht ajo. I kam gdhendur gjer në rruzhë (detajin më të vogël) personazhet që janë protagonist të poezive të mia. Dashuria ime është hapësira poetike që u kam krijuar në vjershat e mia për t'u dhënë pavdekësinë dhe monumentalitetin... etj., etj." Pra, poeti Bardhosh Gaçe "... mbi të gjitha përcakton një poetikë, e cila zgjidh një marrëdhënie të qartë me historinë dhe me realitetin e tanishëm."

Një autor si Bardhosh Gaçe, që në librin e dytë të arkitekturojë individualitetin e tij artistik, nuk është e lehtë, është meritë. Ky tharm, në përmasat e tij, në dukshmërinë dhe padukshmërinë e tij, është i kudoshfaqur. Po t'i hedhim një sy letërsisë sonë shqipe për fëmijë, gjejmë pak autorë që në vëllimet e para kanë shënjuar apo formuar kodin e individualitetit poetik, përkatësinë e përveçësinë. Kështu ka ndodhur me shkrimtarin Bedri Dedja, që në krijimet e tij të para, dhe këtu flasim për prozën, kemi një rrugëtim drejt letërsisë fantastiko-shkencore që erdhi duke e përmbyshur dhe realizuar fisnikërisht. Kemi krijimtarinë e parë të poetit Odhise K. Grillo që u përkujdes për kontrastin dhe kundrapunktin poetik brenda godinës së çdo strofe, ashtu pati edhe një përkujdesje për ta hijeshuar çdo "godinë" me detaje të freskëta poetike. Kemi krijimtarinë e parë të poetit Xhevat Beqaraj me lirizmin fatlum, me ngjyrat e komunikimit dhe detajet fëminore. Kemi krijimtarinë e parë të poetit Tasim Gjokutaj përmes fabulës interesante, të papriturave dhe mjedisit përrallor. Kemi krijimtarinë e parë të poetes Adelina R. Mamaqi me kodin e saj prej nëne e shkrimtareje. Kemi krijimtarinë e parë të poetit (fabulistit) Ferit Lamaj me fabulat, ku motivet ishin sa të traditës aq dhe të bashkëkohësisë, me aq gjetje të befasishme, dhe me aq kërshtëri dhe misteriozitet në dialogun e personazheve, etj. Nuk ishte e vështirë t'i njihje këta krijues, në pas në librat e dytë, të tretë, të... Po ashtu, edhe krijimtarinë poetike, libër pas libri të poetit Bardhosh Gaçe. Duke u ndalur në krijimtarinë e tij, e në një theks që vura në fillim të shkrimit tim për poetin dhe studiuesin Odhise K. Grillo, mendoj që ndoshta është studiuesi më i mirë i poezisë dhe thelbit të saj në bashkëkohësinë me autorin Gaçe. Ja se çfarë thotë: "Karakteristikë e vjershave për fëmijë të poetit Bardhosh Gaçe është: mbështetja në poezinë popullore si dhe në poezinë e traditës. Prej këtyre dy burimeve ai ka marrë gjërat më të mira dhe është munduar t'i shkrijë në vjershat e veta. Ndikimi - në kuptimin më të mirë të fjalës - i poezisë së naimit, Asdrenit e veçanërisht i Çajupit, por edhe i poezisë që është krijuar deri më sot, ndihet në shumicën e vjershave të tij. Ndikimi - edhe këtu në kuptimin më të mirë të fjalës - i gurrës popullore është edhe më i madh. Poeti, në të dy burimet, ka marrë frymën atdhetare dhe e ka ngjizur në krijimet e veta, duke përçuar te lexuesit e vegjël ide, mendime, ndjenja, emociione dhe tema me vlera edukative e estetike. Nga burimi i dytë ka marrë frymën e poezisë popullore dhe me të ka mbrujtur poezitë. Me zotësi, poeti zbulon gjetje të reja, ndërton figura të reja dhe krijon vargje origjinale. Karakteristika tjetër në poezinë për fëmijë të Bardhosh Gaçes është dhe prurja në sofrën e përbashkët të poezisë për fëmijë të asaj që ka më të mirë treva e Vlorës. Bashkë me të ndihet fuqishëm edhe prurja e Tërbaçit, e këtij fshati me emër jo vetëm në Labëri, por edhe më gjerë."

Libri "Vogëlushët e Tërbaçit" (vjersha), nuk ka më shumë se 60 faqe e, me një kopertinë që ka si subjekt motivin e poezisë me të njëjtin titull si të librit. Pra, që në komunikimin e parë, përftojme ndjesinë e një treve që autori e do dhe e njeht shumë mirë. Poezitë që lëvrohen në këtë libër, nga mënyra se si shtjellohen, si ligjërohen, ngjajnë si një ekspozitë me shumë tablo me plot ngjyra të ndezura, ngjajnë si rrëfime, ku çdo rrëfim ka shumë dëshmi. Ngjajnë, gjithashtu, si sekuenca filmi me subjekt historik. Ngjajnë, gjithashtu, si dokumente që fiksojnë një kohë dhe nuk e zverdhin atë. Ngjajnë, gjithashtu, si një Muze, ku flet një histori ekzistente dhe reale, me zërin e saj të vërtetë me plot motive të lavdishme lufte. Poeti Bardhosh Gaçe, me librat e botuar gjer tani, mbetet një ëndërrimtar në "Kopshtin e ëndrrave" dhe një udhëtar i palodhur që kërkon e zbulon motive të reja, dhe që i ngjan atij "Lumi që nuk fle gjumë".

Shkodër, mars, 2023

NJË PELEGRIN I LARGËT NË MALIN TOMORR

(Rreth librit “Në malin e shpirtit të shqiptarëve” të Shkëlzen Limanit)

Dr. Bardhosh GAÇE

Në të gjithë historinë e shkrimeve për njeriun në Shqipëri, psikologjinë e tij jetike, familjen, mjedisin social dhe atë historik, marrëdhëniet e shqiptarëve me njëri - tjetrin, marrëdhëniet me kohën, raportet e qëndrueshme të tyre, studiuesit, hulumtuesit dhe etnologët e kanë parë të lidhur edhe me çështjet e besimit. Besimi, duke qenë ndër domenet më të hershme në jetën dhe veprimtarinë socialo - historike të shqiptarëve, është perceptuar mjaft imët nga studiuesit e huaj, qoftë kur ata kanë kërkuar të krijojnë një raport njohjeje për shqiptarët, qoftë edhe për çështje të tjera të natyrës gjeostrategjike, e cila është bërë e prekshme që në gjysmën e parë të shek. XIX, kur në Ballkan u shfaq nacionalizmi, një fenomen politik që lidhej me statusotë e gadishullit, i cili kërkonte të krijonte raporte të reja historike brenda vetes dhe me shtete e tjera të Evropës Perëndimore dhe atë Lindore.

Gjithsesi, udhëtarët e huaj, kryesisht ata anglezë, gjermanë dhe francezë, por edhe kronistë të shumtë udhëtimin në vendin e shqiptarëve kanë kërkuar ta plotësojnë edhe me eksplorimin e raporteve të besimit që shqiptarët kishin ndër vetvetes dhe si ata silleshin me besimet në përgjithësi, ku shquan një harmoni befasuese për të huajt në veçanti. Studiuesit në veçanti, kanë vërejtur një lloj qartësie që shqiptarët kishin në psikën e tyre për autoritetet e besimit, ku shquhej ndjesia e emancipimit kulturologjik, pavarësisht një prapambetje nga pikëpamja ekonomike dhe të qenit larg metropoleve evropiane, të cilët ishin përfshirë në hapjen e universiteteve dhe shkollave të nivelit bashkëkohor. Shqiptarët natyrshëm kishin përdorë dhe vazhdonin të përdornin mjaft mirë natyrën progresive që besimi i tyre kishte për kohën dhe të ardhmen.

Isha i mendimit, që kjo parashtrësë t'i paraprinte përcjelljes së një opinioni lidhur me një rrugëtim interesant, shpirtëror dhe me një dëshirë për të krijuar një frymëmarrje vertikale dhe horizontale që Shkëlzen Limani nga trojet skajore autoktone shqiptare ka sjellë për një libër interesant, që ngjan me një guidë apo një ese të mrekullueshme në shtegtimin historik shqiptar, por edhe në mjedisin e mrekullueshëm shqiptar, ku njëri nga besimet e hershme që ka lënë gjurmë jo vetëm në kulturën e besimit, por edhe në atë të dijes, arsimit dhe të harmonisë ndër shqiptarët, bektashizmi ka bërë një rrugëtim të gjatë dhe të rëndësishëm në historinë shqiptare.

Libri i titulluar “Në malin e shpirtit të shqiptarëve” është një ese e gjatë, ku shpalojet një shpirt i ndjeshëm, një personazh me një sportivitet të mrekullueshëm në raportet që ai krijon me historinë, me besimet, me njerëzit, me njohjen dhe interpretimet që lidhen me shpirtin shtegtues të shqiptarit që nga kohët e hershme, kur në Shqipëri dhe në trojet shqiptare u shfaq besimi islam dhe bektashizmi. Është një libër i shkruar me dashuri, një rrugëtim i autorit për të eksploruar vende, psikologji njerëzore, një hulumtues i cili merr në “rëndësinë” e këtij komunikimi të tregohet një besimtar i qartë dhe njohës i thellë i besimit, veçmas atij bektashi, si një pelegrin i këndshëm. Duke iu larguar detyrimit shkencor, siç ndodh në të shumtën e rasteve të kënjës natyre, Autori ka ofruar një qasje, një komunikim aq të afërt me psikologjinë e një njeriu të thjeshtë për ta bërë qartë të afërt atë që ai ka parë dhe ka dëgjuar mes njerëzve në një pelegrinazh në Malin e Tomorit, njëri nga më të njohurit jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë Gadishullin Ballkanik për llojin e tij.

Bektashizmi ka një histori të largët kur ai është shfaqur në gjirin e besimit islam dhe lidhet me konceptin fundamental të tij, i



njohur si Hakk-u (e vërteta), i cili ka gjallëruar në elitën njerëzore dhe njërin nga themeluesit e tij, i cili është Haxhi Bektash Veli, një njeri i shenjtë, por edhe mbrojtësi i shenjtë i këtij tarikati. Në momentin kur atë e konsiderojnë “njeri i shenjtë”, pa dyshimin më të vogël, marrëdhënia me të është e pakushtëzuar dhe bashkëjetuese e denjë në rrugëtimin e tij. Në këtë shtegtim shekullor, një rrugëtim që ka ndikuar kaq shumë dhe vazhdimisht në përsosjen e ndërgjegjes së besimit bektashi, që sipas sulujt, një interpretim i njohësve të thellë të bektashizmit synon pandërprerë arritjen e idesë hyjnore, ku mishërohet marrëdhënia me njeriun dhe mes njerëzve, që sipas “shtëpisë” ku ky besim ka ruajtur kohë pas kohe tharmin e vet, siç është teqeja, njërrën nga detyrat më bazike ka dhënëni e bukës nevojtarëve.

Bektashizmi shqiptar ka historinë e tij: ai është shfaqur në Shqipëri bashkë me “pelegrinë” të tillë, siç ishin dervishët shëtitës, të cilët përhapnin filozofinë e Haxhi Bektash Veliut, një praktikë e njohur edhe në disa besime të tjera në botë. Në thelbin e vet bektashizmit lidhet me idenë e përparimit shoqërorë, ndërsa në Shqipëri ai u mishërua në mbështetjen për shkrimin dhe këndimin shqip, mbi fondamentin e të cilës u ngrit dhe Rilindja Shqiptare, duke i kontribuar shumë çështjes kombëtare. Natyrisht autori e kupton mjaft mirë këtë, pasi nuk harron të evidentojë në shënime të tij të rrugëtimin drejt Malit të Tomorit (2021) se sa i përhapur ishte bektashizmi në Shqipëri, se qendra Botërore e Bektashizmit në botë sot është në Tiranë. Në librin “Ngjithja në malin e shpirtit të shqiptarëve” ka një dëshmi interesante, marrë nga rrëfimi i një kleriku të njohur në Shqipëri (Baba Sulejmani), i cili dëshmon se turqit e kishin internuar, pasi klerikë të tillë, besimtarë bektashinj dhe teqetë ishin shndërruar në vatra ku flitej për çështjen kombëtare shqiptare. Deviza e tij se “Ne duam paqen në botë dhe të mirën e njerëzimit!”, kuptohet fare mirë se kjo nuk i shkon për shtat asnjë pushtuesi, siç ishin dhe turqit në Shqipëri në fillimshkullin e kaluar.

Bektashizmi gjeti mjedis të pranueshëm në Shqipëri. Po ashtu, në Shqipëri ai kishte gjetur një harmonizim të provuar historik dhe njerëzor, shqiptarët kishin nevojë për atdheun e tyre, pavarësinë e tyre, e cila ishte cenuar gjatë pushtimit dhe sundimit të tri perandorive, ndërkohë marrëdhëniet e tyre me kohën i përçonte një ide gjeniale e Rilindjes, se “Feja e shqiptarit është shqiptaria!”, një marrëdhënie fundamentale që shqiptarët e kishin demonstruar gjatë gjithë jetës së tyre dhe përballë çdo invizioni ushtarak, kulturologjik dhe të fushave të tjera jetësore. Rilindësit, bektashinj të shquar, vëllezërit Frashëri e kishin modelin e heroit dhe luftëtarit përparimtar kujtimin

dhe veprën e Skënderbeut. Kjo kishte shumë rëndësi për mjedisin politik shqiptar të kohës dhe gjatë gjithë historisë shqiptare.

Pjesën më të madhe të librit “Në malin e shpirtit të shqiptarëve” e zë pelegrinazhi në Malin e Tomorit. Në të gjitha burimet shkrimore dhe ato të mistikës, Mali i Tomorit, i njohur ndryshe si mali i perëndive është përcjellë me një lloj misticiteti antik, që nga autorët e lashtë, të cilët e “zbulojnë” atë si një vend ku “nyjëtohet” i gjithë besimi dhe interpretimi antik. Legjendat, pavarësisht si të tilla, ende nuk kanë arritur t'i heqin misterin dhe mundësinë e të qenit në këtë mal i tempullit të Dodonës, një nga tempujt më të rëndësishëm të antikitetit dhe të mitologjisë ballkaniko - evropiane. Dhe autori i këtij libri, nuk mund t'i shmangej këtij opinioni, i cili ka ardhur dhe vijon të vijë përmes burimeve të shumta shkrimore. Gjithsesi kjo është një nga arsytet e rëndësishme e besimit njerëzor, pse aty qëndroi dhe pushoi Abaz Aliu, njëri nga shenjtët rreth të cilët dhe për të cilin është ushayer besimi popullor dhe adhurimi prej shenjtë. Si i tillë, mali i Tomorit është qaq i beftë, qaq i afërt dhe i largët, qaq i dashur e qaq i sertë, por qaq i imponuar dhe i adhuruar nga njerëzit, aq sa e ka bërë pelegrinazhin e çdovitsëm pranë tij ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri dhe në Ballkan.

Autori librit, pavarësisht përvojës së tij është përpjekur të depërtojë brenda kësaj marrëdhënieje që krijon ideja e parë për të shkruar në Malin e Tomorit, pastaj shpërfaqet gjithë “aventura” e cila ka “peripeçitë” e saj, por gjithsesi e bukur, çliruese, që ka çliruar fuqi dhe besim të njerëzit, dëshirat, vullnetin dhe nevojat e tyre. Nuk thuhet kot “Abaz Aliu të shëron!”, “Abaz Aliu të ndihmon!”, dhe kjo ndodh për shkakun e një çlirimi që ai ngjall në ndërgjegjen e njerëzve. Mali i Tomorit ka pleksur bashkë natyrën, shenjtë, mitet, lashtësinë, ngjarje jo të pakta ndër brezat njerëzorë për të mbartur që herët një adhurim fisnik, i cili e ka tejkaluar përkatësinë e të qenit bektashi. Këtë mesazh e përcjell qaq mirë edhe dëshira për të qenë pelegrin në Malin e Tomorit të autorit të librit “Ngjithja në malin e shpirtit të shqiptarëve”, i cili na ka ofruar një tablo interesante njerëzore të rrugëtimin të tij nga Presheva drejt malit të shenjtë. Pelegrinazhi në Malin e Tomorit është i hershëm, madje është i lashtë, si një dëshmi e njohjes për të cilin ka dëshmi që vijnë përmes rrëfimeve popullore, burimeve antike dhe jo pak legjendave që njerëzit përcjellin nga koha në kohë. Mali i Tomorit në ditët e fundit të gushit i bën bashkë njerëzit nga gjithë anët e vendit, brenda dhe jashtë Shqipërisë, besimtarë dhe pelegrinë të gjithë besimeve, çfarë tregon se ai e tejkalon të qenit një vend i shenjtë i bektashinjve, por një fron perëndish, siç shkruajnë dhe kujtojnë të

gjithë pelegrinët që shkojnë atje.

Qindra - mijëra njerëz, të cilët harrojnë çdo lloj vështirësie dhe pamundësie, e bëjnë këtë ngjarje madhështore qaq popullore, pasi demonstronjë mjaft mirë frymën e shenjtë në këtë vend dhe në objektet e kultit në të gjithë përmasën e vet. Pjesëmarrja e qindra - mijëra njerëzve në pelegrinazh, në Ditët e Tomorit do të impononte këdo pjesëmarrës, sado njohës i mistikës dhe i besimit të ishte për të medituar, si ai “përthithte” qaq shumë njerëz, qaq shumë besim dhe përluje njerëzore, që duket se i bënte gurët, ndërtesat, kolonat, teqetë, varret e shenjtë, drurët, librat, zjarret, dritën, dritën gjithçka që është e pranishme në këto ditë, të kishin një frymë të shenjtë. Të gjithë të barabartë, të gjithë paqësorë, të gjithë meditues, komunikues dhe pjesë e një harmonie të vetvetishme, që buron nga kultu për Abaz Aliun, për frymën e Bektash Veliut, dishepujt e tij dhe martirët e kësaj fryme të shenjtë, e cila prej shekujsh ka mbetur e gjallë në Fronin e Perëndive dhe që frymon në të gjitha teqetë e besimit bektashi në Shqipëri.

Ditët e Tomorit janë magjike, janë ditët ku njeriu ekspozohet me të gjithë vullnetin dhe sinqeritetin e padiskutueshëm përballë frymës që demonstronjë njerëzit e ardhur dhe nga cepat e globit, urtësia dhe përluesia shpirtërore e turmave të mëdha të njerëzve, nga urtësia dhe përluesia e klerikëve të shumtë bektashi dhe të tjerë, të cilët përcjellin të jenë ndërmjetësit e këtyre ditëve të shenjtë mes njeriut dhe shenjtëve. Në Tomor gjatë këtyre ditëve duket se kanë zbritur në tokë të gjitha mirësitë e qiellit dhe të tokës. Autori i librit, i cili është kujdesur të shënojë jo pak detaje nga rrugëtimi i tij për të shkruar në Tomor, por edhe ditët e qëndrimit në Malin e Shenjtë, duke mos e njohur në themel bektashizmin dhe këtë raport të thellë që njeriu ka vendosur me këto kulte të hershme të natyrës, ka bërë një shërbim të mrekullueshëm: ai ka shtuar në burimet njohëse të bektashizmit një përvojë me vlerë, ku më e rëndësishmja është harmonia dhe natyra përparimtare kombëtare, që bektashizmi dhe njerëzit e tij i kanë përcjellë shqiptarëve dhe që vijojnë t'i përcjellin edhe sot.

Ditët pelegrine në Malin e Tomorit janë ditë të mrekullueshme refleksioni për sakrificën njerëzore të martirëve të këtij besimi në emër të njerëzve, mirësisë dhe të ardhmes. Në Malin e Tomorit bëhesh besimtar i pakushtëzuar, dhe kjo është një shërbesë në emër të humanizmit njerëzor, themeli i të cilit është dhe shpirti i bektashizmit.

Në librin “Në malin e shpirtit të shqiptarëve” të Shkëlzen Limanit pelegrinazhi i Tomorit zë pjesën më të madhe, ku natyrisht krahas masës së madhe njerëzore, infrastrukturës së një feste madhështore me kurbanet, shërbimet jetike, kuzhinat, objektet e caktuara që ato ditë i japin frymën e kultit, qindra karaktere njerëzore besimtarësh dhe të profesioneve të tjera, shfaqet edhe profili i ndritur i Kryegjyshit Botëror, i cili përcjell një dritësim të madh shpirtëror, ku më e rëndësishëm është mesazhi i frymës hyjnore që Ditët e Tomorit përcjellin. Fatmirësisht autori i librit arrin ta përcjellë këtë mesazh të rëndësishëm, si një komunikim, i cili ka ardhur përmes vështirësive të shumta që nga kohët e mëhershme, pasi bektashizmi ka pasur vështirësitë e veta gjatë rrugëtimin të tij, ashtu siç ka pasur edhe martirët e tij të shumtë, për të hedhur vështirimin, uratën dhe besimin në të ardhmen. Ky ndërmjetësim madhështor me perëndinë, ku ajo ka lënë shenjat e veta është një fat, që njerëzit e ndiejnë dhe kërkojnë ta prekin. Mjafton të jesh i pranishëm në malin e Tomorit dhe i aftë për ta kuptuar këtë. Këtë kërkon të thotë dhe libri “Në malin e shpirtit të shqiptarëve” i autorit hulumtues, përshkruet të këtij pelegrinazhi, të mirënjohur Shkëlzen Limani nga Presheva.

MELANKOLIA E PAPËRFUNDUAR

Ndërsa hermetizmi nuk është zbehur kurrë, vijon të influencojë dhe evoluojë; me postmodernizmin e neorealizmit të neoavangardës dhe të transavangardës



(Hamdi) Erjon MUÇA

Mbërritëm në fillim shekullin XX, ose në përfundimin e njëres prej etapave mbi të cilat kam medituar. Dhe dua ta mbyll me më melankolikun e hermetikëve, Umberto Saba-n; etapën e parë.

Ndoshta mund të mos e gjeni veten me këta poetë me të cilët rrugëtova, ngaqë shekulli XX u bë laborator i eksperimentimeve më të mëdha poetike të të gjitha kohërave; patëm goditjet prej cunami sarkastik të Prevert-it, tronditjet gjeodezike të abstraksionit të Apolinare-s, ndodhi, si të thuash, një shkarje mendor-artistike futuristike, impresionizëm, ekspresionizëm, ekzistencializëm, por që të gjitha rrymat që me të mbaruar lufta e dytë botërore, nisën të zbeheshin, përveç futurizmit që u zhduk plotësisht dhe që mbeti në historinë artistike botërore si shenja e një ematone traumatike. Ndërsa hermetizmi nuk është zbehur kurrë, vijon të influencojë dhe evoluojë; me postmodernizmin e neorealizmit të neoavangardës dhe të transavangardës.

Umberto Saba është disi më i çuditshëm edhe se Quasimodo, për të qenë hermetik, madje unë deri vonë, e kam pasur të vështirë ta klasifikoj, personalisht si të tillë. Mirëpo duke lexuar e rilexuar, arrita të gjej edhe PSE-në e këtij hermetizmi kaq fluturak; këtij hermetizmi që i ngjet një nate me rëndesë, kur hëna herë zhduket plotësisht e herë duket e plotë, herë fshihet përgjysmë dhe herë tregohet përgjysmë. Herë duket e pastër, e plotë e herë si fshehur pas një vello trishtimi. Kjo ka të bëjë me një formë arti që nis me rilindjen dhe me sa di, i pari, zbuluesi i kësaj forme ka qenë Leonardo Da Vinci. Quhet "Arte non finita" art i papërfunduar, "Arte indefinita" art i papërcaktuar. Mrekullia i këtij arti qëndron tek makrostruktura që nuk lëngon mungesën e përcaktimit të mikrostrukturës dhe të jeni të bindur që nuk është aspak e thjeshtë. Po të vështroni Giocondën e Leonardos do të ndjeni që mungesa e peizazhit të papërfunduar të papërcaktuar nuk e cungon aspak veprën, madje, për mua, ato mangësi e bëjnë të jetë edhe më kryevepër.

Mirëpo si mund të përkthehet kjo veçanti e artit viziv, tek arti i poetik? Kjo është një procedurë e thjeshtë në dukje, por mjaft e vështirë në zbatim. Po të studiosh poetët e tjerë, do të vështrësh se krijesat e tyre kanë një linjë të qartë përvijim, qoftë edhe hermetikët më të rafinuar si, për shembull, Montale. Poezitë e tyre nuk mund t'i lexosh në një mënyrë tjetër, nga ajo e shkruar prej tyre. Ndërsa krijesat e Sabës kanë veçantësi që mund t'i lexosh edhe duke nisur nga strofa nr. 3 më pas 4, më pas 1 dhe 2 dhe në fund 5 me shtojcë. Ose-ose mund të nisësh nga strofa 5 me shtojcë dhe më pas 1, 2, 3, 4 dhe makrostruktura të mos ndjejë cungime.

Por, Saba-n nuk e bën të veçantë vetëm përzjerja e hermetizmit me artin e papërfunduar rinashimental, por është ajo lidhja e hollë mes romantizmit modern të Carduci-t dhe brezit të ri të poetëve italian, pa të cilin do të dukeshin si shfryrja e një presioni social dhe jo si përvijimi evolutiv i nisur me stilnuovon.

Ndërsa veçantia tjetër e Saba-s qëndron tek filozofia e poetikës së tij. Tek poetët e tjerë, duket sikur lënda e parë futet nga jashtë në psiken e poetëve për t'u fermentuar dhe më pas të shpërthejë e distiluar në format më të pamendueshme të mundëshme, në të kundërt me Saba-n që duket sikur edhe lëndën e papërpunuar edhe shpërthimin përfundimtar i ka vetëm brenda vetes. Gjithçka ka shkruar ka të bëjë vetëm me të, është personale, intime, deri në kufijtë ankthshmërisë. Duket sikur ka kaluar jetën duke studiuar vetveten, deri në skutat më të errëta dhe ka arritur qartësojë gjithçka brenda vetes:

i trishtë, por i shndritshëm është rrugëtimi im;
dhe gjithçka në të, deri në hije, është në dritë.

Këtë punim e titullova Melankoli e papërfunduar, ngaqë poezitë e Saba-s edhe kur kanë mbaruar duket sikur kanë nevojë për një fund, ndoshta është ai fundi që inkosho e çdo lexuesi do të donte t'i jepte. Pra, megjithëqë asgjë nuk duket sikur vjen nga jashtë shpirtit të tij, ajo që fermentohet aty duket sikur distilohet në të gjithë shpirtat njerëzor të lexuesve. Kemi një lloj filozofie, që çdo njeri është i gjithë njerëzimi, ose i gjithë njerëzimi është i njëjti individ. Gjithçka ne ndjejmë, në vetvete, është e papërfunduar, e papërcaktuar, një lloj mjerimi, melankolie

universale e copëzuar tek individë e njerëzimit. Janë mjaft të pakët ata individë, artistë, që arrijnë, qoftë edhe për pak çaste ta riunifikojnë për ndjesitë e pak, mjaft pak, të zgjedhurve.

ALL'ANIMA MIA

Dell'inesausta tua miseria godi.
tanto ti valga, anima mia, sapere;
Sì che il tuo male, null'altro, ti giovi.

o forse avventurato è chi s'inganna?
né a se stesso scoprirsi ha in suo potere,
né mai la sua sentenza lo condanna?

Magnianima sei pure, anima nostra;
ma per quali non tuoi casi t'esalti,
sì che un bacio mentito indii ti prostra.

A me la mia miseria è un chiaro giorno
d'estate, quand'ogni aspetto dagli alti
luoghi discopro in ogni suo contorno.

Nulla m'è occulto; tutto è sì vicino
dove l'occhio o il pensiero mi conduce.
Triste ma soleggiato è il mio cammino;
e tutto in esso, fino l'ombra, è in luce.

SHPIRTIT TIM

Në të pashtershmim mjerim tëndin shijo,
shumë të vleftë, shpirti im, ta dish;
Kështu pra dhimbja jote, asgjë tjetër, të ngazëlleftë.

Mos ndoshta aventurë është kush vetëmashtrohet?
dhe as vetes t'i zbulohet ka nën fuqinë e tij,
as kurrë një vendim i veti s'e dënon?

Mirëbërëse je edhe, shpirti ynë;
po për të cilat çështje jo tuat bymehesh,
Kështu që një puthje e rreme më pas të përkul.

Për mua mjerimi im është një ditë e qashtë
vere, kur çdo veçanti nga të tjera
vende zbuloj në çdo të tijn kontur.

Asgjë më është e mistershme; gjithçka është më e afërt
Ku syri apo mendimi më drejton.
i trishtë por i shndritshëm është rrugëtimi im;
dhe gjithçka në të, deri edhe hije, është në dritë.

NUMRI I ARDHSHEM ME 10 PRILL

HEJZA

01 PRILL, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtör: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000